

# URTËSIA

REVISTË FETARE, SHOQËRORE, ARTISTIKE.

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË

KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE.

NR. 145 / QERSHOR / 2022



## Festë bektashiane në Volos të Greqisë

NË 542-VJETORIN E THEMELIMIT  
TË TEQESË, “DURBALLI SULLTAN”







# Në brendësi:

## Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Dede Edmond Brahimaj, 11 vjet në krye të Selisë së Shenjtë Bektashiane

Si xhënësi i Dede Reshatit, Kryegjyshi Edmond Brahimaj, jo vetëm përmbushi realizimin e këtyre projekteve, ndërtimin e odeonit në Selinë e Shenjtë, teqeve e tyrbeve në mbarë vendin e më gjerë, por shënoi dhe një sërë arritjesh të tjera në përhapjen e besimit bektashian, shtimin e radhëve të besimtarëve, dhënien e mesazheve të unitetit, bashkëjetesës fetare, paqes e mirësisë. Në këtë ditë, Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pret urime në Selinë e Shenjtë, nga besimtarë të shumtë, personalitete etj.

FAQE 7

**Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve**  
Dede Edmond Brahimaj, 11 vjet në krye të Selisë së Shenjtë Bektashiane

Si xhënësi i Dede Reshatit, Kryegjyshi Edmond Brahimaj, jo vetëm përmbushi realizimin e këtyre projekteve, ndërtimin e odeonit në Selinë e Shenjtë, teqeve e tyrbeve në mbarë vendin e më gjerë, por shënoi dhe një sërë arritjesh të tjera në përhapjen e besimit bektashian, shtimin e radhëve të besimtarëve, dhënien e mesazheve të unitetit, bashkëjetesës fetare, paqes e mirësisë. Në këtë ditë, Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pret urime në Selinë e Shenjtë, nga besimtarë të shumtë, personalitete etj.



## Gazetarë e studiuës të njohur amerikanë, vizitojnë teqenë bektashiane të Gjakovës

Historia tetëshkulllore e besimit të paqtë bektashian, trashëgimia shpirtërore e kulturore e tij, predikimi për paqe, bashkëjetesë ndërfetare e harmoni, adhurimi në Zot dhe dashuria vëllazërore pa dallim besimi fetar, etnie, race e ngjyre, përherë e më shumë por gjen mbështetje, duke ngjallë dhe interesin e studiuësve të njohur botërorë. Kështu, dhe historia dhe trashëgimia bektashiane në trevat shqiptare, përherë ka tërhequr vëmendje mbarëkombëtare.

FAQE 34

**Gazetarë e studiuës të njohur amerikanë, vizitojnë teqenë bektashiane të Gjakovës**

Historia tetëshkulllore e besimit të paqtë bektashian, trashëgimia shpirtërore e kulturore e tij, predikimi për paqe, bashkëjetesë ndërfetare e harmoni, adhurimi në Zot dhe dashuria vëllazërore pa dallim besimi fetar, etnie, race e ngjyre, përherë e më shumë por gjen mbështetje, duke ngjallë dhe interesin e studiuësve të njohur botërorë. Kështu, dhe historia dhe trashëgimia bektashiane në trevat shqiptare, përherë ka tërhequr vëmendje mbarëkombëtare.

Historia tetëshkulllore e besimit të paqtë bektashian, trashëgimia shpirtërore e kulturore e tij, predikimi për paqe, bashkëjetesë ndërfetare e harmoni, adhurimi në Zot dhe dashuria vëllazërore pa dallim besimi fetar, etnie, race e ngjyre, përherë e më shumë por gjen mbështetje, duke ngjallë dhe interesin e studiuësve të njohur botërorë. Kështu, dhe historia dhe trashëgimia bektashiane në trevat shqiptare, përherë ka tërhequr vëmendje mbarëkombëtare.

## Dede Edmond Brahimaj në seminarin për tolerancën dhe harmoninë fetare: "Dashuria dhe paqja është lumturia jonë, lumturi tjetër nuk ka!"

Disa përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare vizituan Gjermaninë, në datat 18-20 maj 2022. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, flet për DW mbi rezonancën e tolerancës fetare ndër shqiptarët.

-Dede Edmond Brahimaj: Gjermanët janë një popull me kulturë, këtë e treguan nga mikpritja, që na dhuruan në të gjitha takimet tona, na respektuan duke filluar nga personalitetet, por edhe nga populli gjerman, me shumë respekt, me shumë dashuri...

FAQE 25

**Dede Edmond Brahimaj në seminarin për tolerancën dhe harmoninë fetare: "Dashuria dhe paqja është lumturia jonë, lumturi tjetër nuk ka!"**

Disa përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare vizituan Gjermaninë, në datat 18-20 maj 2022. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, flet për DW mbi rezonancën e tolerancës fetare ndër shqiptarët.

Disa përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare vizituan Gjermaninë, në datat 18-20 maj 2022. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, flet për DW mbi rezonancën e tolerancës fetare ndër shqiptarët.



# FESTË BEKTASHIANE NË VOLOS TË GREQISË, NË 542-VJETORIN E THEMELIMIT TË TEQESË “DURBALLI SULLTAN”



**P**as një ndërprerjeje dyvjeçare, për shkak të pandemisë Covid-19, të dielën (më 1 maj 2022), në Volos të Greqisë, u organizua pelegrinazhi tradicional vjetor, në teqenë e njohur të “Durballi Sulltanit”, aktivitet që përkon sivjet dhe me 542-vjetorin e themelimit të teqesë. Ceremonia fetare e festive, që nga masat përgatitore e deri në realizimin e saj, u bë nën përkuqjesjen e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtërisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në bashkëpunim me komunitetin e besimtarëve bektashianë, kryesisht shqiptarë në emigrim në Greqi. Në këtë ceremoni, përveç besimtarëve me banim në Greqi, morën pjesë dhe klerikë bektashianë e besimtarë të tjerë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, hapësira të tjera mbarëshqiptare, e komunitete që jetojnë në Evropë e më gjerë. Nga Ambasada e Shqipërisë në Athinë, mori pjesë dhe përshëndeti, Atashe Diplomatik, Z. Roland Berzani. E veçanta e pelegrinazhit të këtij viti, ishte se shumë besimtarë, kryesisht nga Shqipëria, kishin udhëtuar një ditë më parë e ishin vendosur në mjediset e bukura të teqesë, për ta pritur ditën e pelegrinazhit, si “banorë vendas”.

Ceremonia, që nisi në orën 11:00, u hap nga Saimir Osmani, përfaqësues i komunitetit të besimtarëve bektashianë shqiptarë, në emigracion në Greqi. Ai falën-





deroi Kryegjyshin Botëror për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë, si dhe gjithë pjesëmarrësit në aktivitet. Në vazhdim, ia dha fjalën Dede Edmond Brahimajt, për përshëndetjen e rastit dhe ritet e ditës së pelegrinazhit bektashian.

**PËRSHËNDETJA E KRYEGJYSHIT BOTËROR**

Në përshëndetjen me këtë rast, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij,

Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ndër të tjera tha: "...Të nderuar vëllezër të mi klerikë,

miq besimtarë e dashamirës, që sot jeni mbledhur bashkë me ne për të përkujtuar 542-vjetorin e themelimit të Teqesë "Durballi Sulltan", këtë ditë të shënuar për Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, por edhe për të gjithë bektashinjtë në Greqi e veçanërisht në zonën Volos, Greqi. Historia e lashtësisë dhe rrënjëve të forta bektashiane të kësaj teqeje, daton plot 542 vjet më parë, e themeluar në vitin 1480 në Farsalla të Greqisë, tregon për hershmërinë e ngritjes së teqeve në Ballkan dhe

**“** Ceremonia fetare e festive, që nga masat përgatitore e deri në realizimin e saj, u bë nën përkujdesjen e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtërisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në bashkëpunim me komunitetin e besimtarëve bektashianë, kryesisht shqiptarë në emigrim në Greqi. Në këtë ceremoni, përveç besimtarëve me banim në Greqi, morën pjesë dhe klerikë bektashianë e besimtarë të tjerë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut

**VIJON NË FAQEN 6 >>**





Teqeja "Durballi Sulltan", Volos, Greqi



Momente nga ceremonia

rrezatimin e ndikimin e saj edhe në Shqipëri. Teqeja e mori emrin nga misionari i saj, që punoi me përkushtim jo vetëm për themelimin e teqesë, por dhe përkushtimin e kontributin e madh që dha në vitet 1480-1552 gjatë drejtimit të saj, deri kur kaloi nga jeta. Durballi Sulltani, ky misionar, ishte dërguar nga Sejid Ali Sulltani, i teqesë së Dimotekës në Bullgari, i cili hodhi farën e bektashizmit në Ballkan dhe themeloi teqenë e parë bektashiane në Farsalla (Thesali) të Greqisë. Ai ka qenë një nga shenjtoret e mëdhenj dhe njihet si i tillë dhe sot, nga e gjithë popullata greke e vendosur në viset rreth e rrotull teqesë.

Edhe sot kjo popullatë përulet me respekt për Durballi Sulltanin. Baballarët e kësaj teqeje historike kanë qenë pothuajse shqiptarë, të cilët kanë predikuar kurdoherë kombësinë shqiptare, si të gjithë baballarët e teqeve të Shqipërisë, që kanë qenë qendrat e shqiptarisë në kohën e sundimit turk. Sot teqeja është pothuajse në rrënim dhe përsëri tregon famën e saj arkitekturore dhe historinë e famshme të derivishëve dhe baballarëve. E rrethuan me tela me gjemba dhe me roje për dekada të tëra teqenë e njohur

të "Durballi Sulltanit", në Volos të Greqisë, ushtruan presion e dhunë ndaj besimtarëve, të cilëve u mohonin vizitat e pelegrinazhet në këtë vend të shenjtë, por nuk mundën që të ndërpresin lidhjet shpirtërore dhe udhën e shpresës së besimtarëve me rrugën e Haxhi Bektash Veliut, derisa u arrit që kjo strehë e mohuar, të ribëhet strehë e besimtarëve.

Pikërisht, është mbështetja e miliona besimtarëve bektashinj kudo në botë, që ne marrim forcë për realizimin e këtij objekti. Rasti i teqesë së Volosit në Greqi, është produkt i kësaj pune. Me këtë rast, unë dua të falënderoj kryesisht besimtarët emigrantë, Ambasadorët e Shqipërisë, konsujt e të gjithë trupin diplomatik."

#### PËRSHËNDETJA E ATASHEUT SHQIPTAR NË GREQI

Në vijim të aktivitetit, të pranishmit i përshëndeti përfaqësuesi i Ambasadës së Shqipërisë në Athinë, Greqi, i cili ndër të tjera tha: "...Jam shumë i lumtur që ndodhem sot mes besimtarëve që janë mbledhur këtu në Volos, në këtë teqe bektashiane me emër,

përkrah Dede Edmondit e miqve të tjerë besimtarë shqiptarë, grekë e të shumë kombeve të tjera, që i bashkon besimi e adhurimi në Zot. Ju përshëndes në emër të Ambasadores Hajdaraga, e cila për arsye pune, nuk ndodhet sot midis jush në këtë vend të bekuar. Jam i gëzuar, gjithashtu, që sivjet shoh më shumë pelegrinë nga Shqipëria, emigrantë të ardhur nga treva të ndryshme të Greqisë e jashtë saj, nga vende aziatike, nga Turqia, Iraku, SHBA, vende të Afrikës e nga shtete të Evropës, pasi bashkëbisedimi, kryerja e riteve në gjuhë të ndryshme por së bashku, i shërben më shumë paqes, dashurisë njerëzore, dhe harmonisë. Dua të falënderoj Dede Edmond Brahimajn, Kreun e Bektashizmit Botëror, i cili me përkushtimin e Tij maksimal, bashkë me klerikë vëllezër të tij bektashinj në mbarë botën, që përherë e më shumë po reflektohet në forcimin e bashkëjetesës fetare, lirisë e paqes globale. U uroj të gjithëve mbarësi, shëndet e lumturi në familje dhe vëllazëri e impenjim për të mirën, për të zgjidhur sa më shpejt e më mirë një sërë problemesh me të cilat po përballet sot njerëzimi...!"





# KRYEGJYSHI BOTËROR I BEKTASHINJVE, DEDE EDMOND BRAHIMAJ, 11 VJET NË KRYE TË SELISË SË SHENJTË BEKTASHIANE

**S**i nxënësi i Dede Reshatit, Kryegjyshi Edmond Brahimaj, jo vetëm përmbushi realizimin e këtyre projekteve, ndërtimin e odeonit në Selinë e Shenjtë, teqeve e tyrbeve në mbarë vendin e më gjerë, por shënoi dhe

një sërë arritjesh të tjera në përhapjen e besimit bektashian, shtimin e radhëve të besimtarëve, dhënien e mesazheve të unitetit, bashkëjetesës fetare, paqes e mirësisë. Në këtë ditë, Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pret urime në





Selinë e Shenjtë, nga besimtarë të shumtë, personalitete etj.

Më 11 qershor 2022, u mbushën 11 vjet nga dita kur kleriku Dede Edmond Brahimaj, u zgjodh në detyrën më të lartë të tarikatit bektashian, në atë të Kryetarit të Komunitetit Botëror Bektashian. Kjo ditë e rëndësishme shënon pikënisjen e përkushtimit maksimal të Tij për të çuar më tej projektet e nisura nga Dede Reshati...

### Zgjedhja Kryegjysh Botëror i Bektashizmit

Dede Edmond Brahimaj u zgjodh në detyrën e Kryegjyshit Botëror Bektashian pas ndarjes nga jeta të Dede Reshat Bardhit, një nga personalitetet e njohura të Bektashizmit në mbi 800 vite të ekzistencës së tij, që ndër të tjera, ka meritën e veçantë të ringritjes së besimit bektashian dhe të objekteve të këtij besimi, pas ndryshimeve politike të vitit 1990 në Shqipëri. Vendimi që zgjodhi Dede Edmond Brahimajn Kryetar të Komunitetit Bektashian Botëror, mban datën 11.06.2011. Ndër të tjera, në këtë vendim thuhet: “Në zbatim të nenit 21 të Statutit të Kryegjyshit Botëror Bektashian, datë 26.07.2009 të ndryshuar dhe të miratuar me Vendim Gjykatë Nr. 4760/1, datë 22.12.2009, Këshilli i Lartë Gjyshnor, në bashkëpunim me Këshillin Klerikal, i mbledhur sot më datë 11.06.2011 në mjediset e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Vendosi: 1. Zgjedhjen e Haxhi Baba Edmond Brahimaj, në detyrën e Kryetarit të Komunitetit Bektashian Botëror.”

### Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve

Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka lindur në Tiranë, më 19 maj 1959. Është me origjinë nga fshati Brataj i Vlorës. Ka kryer arsimin e lartë ushtarak dhe juridik. Më 2 janar 1992, fillon jetën si klerik, me bekimin e udhëheqësit të tij shpirtëror, Haxhi Dede Reshat Bardhit dhe Baba Bajram Mahmutaj, duke u inkuadruar kështu përfundimisht në rrugën e Haxhi


Bektash Veliut. Më 16 maj 1996 konsakrohet me urdhrin Dervish dhe menjëherë ngarkohet me detyrë në Gjyshatën Bektashiane të Turanit, në Korçë. Më 13 prill të vitit 1997 dekretohet me titullin “Baba”. Po në vitin 1997 caktohet Zëvendës i Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Më 21.02.2006, emërohet edhe si drejtues i Bektashizmit në Maqedoni, me qendër në Tetovë, duke mbajtur njëkohësisht postin e Zëvendës-Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Më 11.06.2011, me Vendim të Këshillit të Lartë Gjyshëror të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u zgjodh në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Haxhi Dede

Edmond Brahimaj është një nga klerikët e hierarkisë së lartë Bektashiane, që ka dhënë kontribut të veçantë për ringritjen e strukturave dhe të infrastrukturës së Bektashizmit, në Shqipëri dhe në Botë.

### Përkushtimi ndaj bektashizmit

Që nga viti 1992 e në vazhdim, Haxhi Dede Edmond Brahimaj ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizatave prestigjioze ndërkombëtare, kurse doktrinale, simpoziume dhe veprimtari të ndryshme me karakter fetar, human, social, ku edhe ka referuar, duke çuar në to zërin dhe përvojat e bashkësive bektashiane në Botë. Më 1996 referoi në Teheran lidhur me tolerancën bektashiane në trevat e Ballkanit. Më 14 qershor

2003, në Konferencën Ndërkombëtare “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e Ri”, referoi rreth sfidave të Bektashizmit në të ardhmen. Në qershor 2004, si një ndër përfaqësuesit e bashkësive fetare tradicionale shqiptare, vizitoi Shtëpinë e Bardhë në SHBA. Ka shkuar në SHBA nëpërmjet Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri, për njohjen e diversitetit fetar në SHBA. Ka mbajtur marrëdhënie të veçanta me Gjyshatën Bektashiane në Detroit, SHBA, në Teqenë e Baba Rexhepit, qendër e rëndësishme e Bektashizmit, e











cila u shndërrua në qendrën kryesore të Bektashizmit gjatë kohës së ndalimit të fesë në Shqipëri dhe ka marrë pjesë në veprimtari të ndryshme në këtë Gjyshatë. Mban titullin “Ambasador i Paqes”. Ka marrë pjesë disa herë në festimet e 16 gushtit në Haxhi Bektash të Turqisë, ku është pritur nga drejtues të lartë të shtetit turk dhe të Institutit “Haxhi Bektash Veliu”, pranë Universitetit të Gazit në Turqi. Ka qenë i pranishëm dhe ka kontribuar me ligjëratat e tij në veprimtari të ndryshme në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Ohër, Stamboll, Ankara, Afyon, Stutgart, Keln etj. Haxhi Dede Edmond Brahimaj ka marrë shumë falënderime dhe konsiderata të larta prej qeverive të Shqipërisë, Maqedonisë, shoqërisë civile etj. Trupi diplomatik i akredituar në Shkup e ka vlerësuar lart Haxhi Dede Edmond Brahimajn, si një klerik me kontribut të ndjeshëm, veçanërisht në fushat e marrëdhënieve e bashkëjetesës ndërjetare dhe të harmonisë fetare dhe si promovues të vlerave të Shqipërisë, si vend model në botë në këto fusha.

#### **Vlerësime**

Për kontributin e dhënë për bektashizmin në botë, paqen e harmoninë në Shqipëri e më gjerë, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimajt, i janë dhënë shumë mirënjohje zyrtare e organizma shoqërorë. Ndër to mund të përmendim: “Ambasador i Paqes” në vitin 2004, “Nderi i Qarkut të Korçës” në vitin 2004, “Qytetar Nderi” i Komunës Zerqan-Bulqizë

në qershor 2014, “Qytetar Nderi” i Komunës Martanesh-Bulqizë në qershor 2014, “Qytetar Nderi” i Komunës Bogovë-Skrapar në gusht 2014, “Qytetar Nderi” i Komunës Frashër-Përmet, në maj 2014, “Personalitet i shquar i Labërisë” në shkurt 2015, “Qytetar Nderi” i Qarkut të Fierit në mars 2015, “Qytetar Nderi i Qarkut të Beratit” në maj 2015, “Qytetar Nderi i Bulqizës”, Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” në shtator 2015, “Qytetar Nderi” i Shoqatës Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare “Vëllezërit Frashëri”-Përmet, maj 2018, si dhe në vitin 2019 është nderuar nga Këshilli Bashkiak i Memaliajt me titullin “Qytetar Nderi i Memaliajt”. Më 26 qershor 2019, Dr. Munir Kazmir, nënkryetar i Kongresit të Hebrenjve, nderoi dhe i dhuroi në shenjë mirënjohjeje Shenjtërisë së Tij dhe Komunitetit Bektashian, Flamurin Amerikan, “Për kontributin e shquar në përhapjen e fjalës së Zotit dhe vlerave më të larta mes njerëzve”. Në janar 2021, Shenjtëria e Tij drejtoi Kryesinë e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë dhe më dt. 22 mars 2021, Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë iu dha medalja e lartë “Nderi i Kombit” dhe në nëntor 2021 u nderua nga Universiteti Teknik i Këlnit, Gjermani, me çmimin “Unaza e Tolerancës”, me motivacionin “për Përpjekjet dhe mundimet e vlefshme në angazhimet për paqen dhe nxitjen e dialogut ndërjetar, si shembull i veçantë dhe i denjë për t’u ndjekur, në ndërtimin, promovimin dhe mbrojtjen e tolerancës”.



# *Pjesë të universit naimian, në “Ditët naimjane”, në ditëlindjen e bektashiut të madh, në Përmet*

Pjesë të universit naimian në “Ditët Naimjane”, në vendlindjen e bektashiut të madh, u sollën në datat 24-25 maj 2022, në vepërimtarinë shkencore e kulturore, “20 Vite Dita Naimjane”, organizuar në qytetin e Përmetit dhe në Frashër, nga Shoqata Kulturore Mbarëkombëtare “Vëllezërit Frashëri”, në bashkëpunim me Bashkinë e Përmetit, Kryegjyshit Botëror Bektashianë, Ministrinë e Kulturës dhe Komunën Rahovec, të Kosovës. Merrnin pjesë, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Shenjtëria e tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryetarja e Bashkisë të Përmetit, Znj. Alma Hoxha, akademikët, Marenglen Verli, Beqir Meta, historiani Kastriot Bezati, poetë nga rrethet e ndryshme të vendit, nxënës nga Komuna Rahovec Kosovë, nga Kumanova e Maqedonisë dhe pjesëmarrës nga Përmeti, Fieri, Tirana etj.



Pamje nga aktiviteti në Përmet

## **KONFERENCA SHKENCORE**

Pasditen e 24 majit, në ambientet e Qendrës Multikulturore Përmet u zhvillua Konferenca Shkencore me temë “Rilindja kombëtare dhe kontributi i vëllezërve Frashëri”. Aktiviteti filloi me përshëndetjen e Kryetarit të Shoqatës “Vëllezërit Frashëri”, Z. Tomorr Kotorri. Më pas përshëndeti Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi



[VIJON NË FAQEN 12 >>>](#)





Dede Edmond Brahimaj, i cili, ndër të tjera theksoi: “...Vëllezërit Frashëri, Avdyli, Naimi, Samiu përbëjnë trinomin e veçantë të historisë, të kulturës dhe letërsisë shqiptare. Kontributi që këta tre dijetarë rilindas të pakrahueshëm, që me anë të penës i kanë dhënë kombit e Atdheut, është kontributi më i çmuar dhe më i rëndësishëm i kohës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Sado të larmishme nga njëra-tjetra qenë ndihmesat e tyre, Abdyl Frashëri politikan, Naim Frashëri poet, kurse Sami Frashëri ideolog dhe dijetar, të tre këta vëllezër nga fshati Frashër në Shqipërinë e jugut, patën një gjë të përbashkët: aspiratën e thellë e dëshirën e zjarrtë për vetëvendosje të popullit të tyre që vuante nën zgjedhën turke. Kontributi i veçantë që Naim Frashëri ka dhënë për bektashizmin, ka rrënjësor edhe më thellë besimin bektashi të qindra e mijëra shqiptarë anekënd botës në veprën e tij të vogël fizikisht, por aq të madhe e të pashembullt në pikëpamjen letrare. Fletorja përmban një paraqitje hyrëse të besimit bektashian dhe dhjetë vjersha fetare që japin një tablo të rrallë, të besimit tonë bektashian, i cili në shekullin e nëntëmbëdhjetë luajti një rol të rëndësishëm për mbijetesën e kulturës shqiptare, sidomos me përhapjen fshehurazi të librave shqip. Kjo udhë është udhë e mirësisë, e miqësisë, e urtësisë dhe e vëllazërisë. Të gjitha janë te njeriu, edhe Zot i vërtetë vetë. Se kur desh të dil në shesh bëri njerinë me fytyrën e tija.”

Përsëritet në vazhdim, Kryetarja e Bashkisë Znj. Alma Hoxha, e cila me këtë rast, i dha Kryetarit të Komunës Rahovec-Kosovë, Z. Latif Smajli, titullin “Qytetar Nderi i Qytetit të Përmetit”. Pas tij, akademiku Marenglen Verli, kumtoi studimin, “Abdyl Frashëri



në ngritjen e identitetit kombëtar” dhe më pas, akademiku Beqir Meta, me kumtesën “Mbi çështjen çame”; poeti Lumo Kolleshi mbi “Qerebelanë e Naim Frashërit”, historiani Kastriot Bezati me “Naim Frashëri dhe roli i tij në letërsinë shqipe” dhe studiuesi Nuri Çuni, me kumtesën “Kontributi i klerikëve bektashianë në periudhën e Rilindjes kombëtare”. Në vijimësi u vizitua ekspozita fotografike, “Ti Shqipëri më jep nder..!”

Dita e dytë e veprimtarive vazhdoi në Frashër, te shtëpia e vëllezërve Frashëri, me vendosjen e kurorave me lule nga Shoqata “Vëllezërit Frashëri”; Kryegjyshata Botërore Bektashiane; Bashkia Përmet. Me interes u ndoq poetika me recitime, nga poeti Haxhi Kalluçi dhe

poetë të ndryshëm nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Një vizitë mbresëlënëse u bë në Muzeun e vëllezërve Frashëri, u diskutua si të jetë Frashëri në të ardhmen, me një rrugë normale që të mbahet gjallë dhe të kthehet në një vend turistik të rëndësishëm gjithëvjetor. Grupet artistike të shkollave të Përmetit dhe Suharekës, i dhanë gjallëri të veçantë kësaj dite historike. Gjithashtu, nga Shoqata e Vëllezërve Frashëri u dha certifikata: “Nderi i Shoqatës Vëllezërit Frashëri”.

...Një vizitë në teqenë e Frashërit, e restauruar dhe me mjedise të mrekullueshme, e bërë nga baba Hekuran Nikollari i teqesë Ali-postivani. Dita naimiane e sivjetshme, solli disa risi.

**Korresp., “Urtësia”**



## Dede Edmond Brahimaj e baba Hekuran Nikollari, takim vëllazëror dhe bashkërendim masash, për pelegrinazhin, në teqenë e Alipostivanit, Përmet



**M**ë 12 maj 2022, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, vizitoi teqenë e Alipostivanit, në prag të 14 majit, Pelegrinazhit tradicional në këtë teqe. Gjatë kësaj vizite Kryegjyshi Botëror, u prit nga baba Hekuran Nikollari, i cili e drejton aktualisht këtë objekt të rëndësishëm bektashian. Kryegjyshi e përgëzoi baba Hekuranin, për punën e mirë që po bën për ringritjen e teqeve bektashiane dhe ringjalljen e bektashizmit në zemrat e besimtarëve. Si teqe është themeluar nga Abdullah Babai dhe mund të jetë ndër-

tuar, rreth vitit 1860. Është djegur nga andartët grekë në vitin 1914, është rindërtuar në vitin 1920 dhe u mbyll nga shteti monist në vitin 1967. Si teqe u rihap në maj të vitit 2003, duke u ringritur dhe restauruar plotësisht kohët e fundit dhe sot, kjo teqe madhështore, është e kompletuar dhe me të gjitha mjediset e saj funksionale, me kupolë dhe ambiente të bollshme karakteristike bektashiane. Një mrekulli e natyrës, ku tyrbet dhe teqeja me natyrën përreth, krijojnë një nga bukuritë e veçanta në luginën e Vjosës.



*Në vend të një urimi për ditëlindjen e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtërisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj*



## Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka 63-vjetorin e lindjes

**M**ë 18 maj 2022, Kryegjyshi Botëror i Bektashizmit, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mbushi 63 vjeç. Në këtë ditë, në Selinë e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, priten vizita dhe urime.

Dede Edmond Brahimaj, ka lindur në Tiranë më 19 maj 1959, prej prindërisht besimtarë të devotshëm të bektashizmit, me origjinë nga fshati Brataj i Vlorës. Pas mbarimit të shkollës 8-vjeçare, vazhdoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, të cilën e përfundon me rezultate të larta. Në vazhdim, i jepet e drejta të ndjekë studimet e larta ushtarake, në Akademinë e Forcave Tokësore, sot “Skënderbej”. Nga viti 1982 dhe deri më vitin 1990, ka shërbyer në funksione të ndryshme ushtarake, në Burrel dhe Peshkopi. Me ringjalljen e besim-

it bektashian në fund të viteve ‘90, së bashku me klerikë dhe besimtarë të tjerë, merr pjesë në Këshillin Organizativ të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botëror Bektashian, për rihapjen e saj. Në fillim të vitit 1991, me kërkesën e tij, lirohet nga funksioni ushtarak, duke marrë përsipër barrën për organizimin e Komunitetit Bektashian. Vlen të theksohet se edhe në kushtet më të vështira, atëherë kur ushtrimi i besimit fetar në Shqipëri u ndalua me nen të veçantë të Kushtetutës, shtëpia e prindërve të tij në Tiranë ka shërbyer për mbajtjen gjallë të bektashizmit, duke u rrezikuar shumë prej regjimit që nuk falte. Më dy janar të vitit 1992, ai merr dorë tek udhëheqësi i tij shpirtëror, Haxhi Dede Reshat Bardhi dhe Baba Barjam Mahmutaj, duke u inkuadruar kështu përfundimisht në rrugën e Pirit të ndritur, Haxhi Bektash





## Urime të personaliteteve

*Në ditën e 63-vjetorit të ditëlindjes, të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, më 19 maj 2022, pati urime të shumta nga personalitete, komunitete fetare, klerikë, diplomatë, qeveritarë, akademikë, profesorë, besimtarë të shumtë, myhib dhe dashamirës. Një Urim i veçantë ishte nga Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama. Vizitorë të shumtë, priti Kryegjyshi, Dede Edmond Brahimaj, në Selinë e Shenjtë në Tiranë, gjatë gjithë ditës. Gjithashtu, erdhën përfaqësuesit nga Gjyshata e Gjakovës në Kosovë, Tetovës në Maqedoninë e Veriut, si dhe urimet nga gjithë gjyshatat e Shqipërisë dhe nga bota. Takim urimi, pati edhe me kolektivin e mjekëve të spitalit Kontinental.*

Veliut. Këtu zë fill karriera e tij fetare. Më 16 maj të vitit 1996, konsakrohet me urdhrin “Dervish” dhe ngarkohet me detyrë në teqenë e Turanit, në Gjyshatën Bektashiane Korçë.

Puna e palodhur e tij për ringritjen e besimit bektashian në Librazhd, Pogradec, Mokër, Korçë, Devoll dhe Kavajë, bëri që më 13 prill të vitit 1997, të dekretohet me titullin “Baba” dhe pas kalimit nga kjo jetë e baba Bajram Mahmutajt, caktohet si zëvendës i parë i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Reshat Bardhi. Në këtë funksion të lartë, kontributi i tij ka qenë i çmuar, sidomos në ideimin, përgatitjen dhe realizimin e tri kongreseve të radhës të bektashizmit. Madje, në dy kongreset e fundit (Tiranë 2000 dhe 2005), ka raportuar në cilësinë e përgjegjës të Këshillit të Lartë Gjyshëror. Në marsin e vitit 2006, me kalimin nga jeta të Baba Tahir Eminit, gjithashtu, emërohet në funksionin e gjyshit të gjyshatës bektashiane në Maqedoni. Kontributi i tij në këtë gjyshatë ka qenë sa në rrafsh të organizimit të komuniteteve të besimtarëve atje, edhe në aspektin e njohjes prej ndërkombëtarëve. Si në Korçë edhe në Tetovë, Haxhi Baba Edmond Brahimaj ka manifestuar cilësitë e spikatura të klerikut bektashian në aspektin doktrinor, moral dhe qytetar, duke u shndërruar në faktor i tolerancës fetare midis besimtarëve të tjera. Në vitin 2004, për kontributin e çmuar të tij, Këshilli Bashkiak i Qarkut të Korçës e ka

nderuar me titullin më të lartë “Nderi i Qarkut të Korçës”. Ai ka marrë shumë falënderime dhe konsiderata të larta prej qeverive të Shqipërisë dhe Maqedonisë, shoqatave civile. Gjithashtu, trupi diplomatik i akredituar në Shkup, e ka vlerësuar atë lart si njeri me të gjitha atributet e një prijësi fetar, posaçërisht,

VIJON NË FAQEN 16 >>



<< VIJON NGA FAQJA 15

roli i tij paqësor në Harabati Baba, teqe në Tetovë, sidomos dhe mënyrën si përballej me diskriminimin ligjor ndaj Komunitetit Bektashian, duke përdorur urtësinë, zgjuarsinë. Ai ishte dhe mbetet njeriu i fjalës së urtë, të ëmbël dhe të mençur.

Që nga viti 1992 e në vazhdim, Haxhi Baba Edmond Brahimaj ka marrë pjesë në trajnime të organizatave prestigjioze ndërkombëtare, kurse doktrimore, simpoziume dhe veprimtari të ndryshme me karakter fetar, human dhe social, ku edhe ka referuar duke çuar aty zërin dhe eksperiencat e komuniteteve bektashiane të kudondodhura në botë. Kështu më 1996, referoi në Teheran lidhur me tolerancën bektashiane në trevat e Ballkanit. Më 14 qershor 2003, në Konferencën Ndërkombëtare “Fetë dhe Civilizimet në mijëvjeçarin e ri”, referon rreth sfidave të bektashizmit në të ardhmen. Në qershor 2004, në kuadër të trajnimeve të organizatës të Komuniteteve fetare tradicionale shqiptare, viziton shtëpinë e Bardhë në SHBA. Nga bordi i kësaj organizate ka merituar titullin “Ambasadori i Paqes”. Ka shkuar në SHBA i ftuar nga Departamenti i Shtetit dhe nga ambasada amerikane në Shqipëri për një periudhë 21-ditore për diversitetin e fesë në SHBA. Ka marrë pjesë disa herë në festimet e 16 gushtit në Haxhi Bektash të Turqisë, ku është pritur nga drejtues të lartë të shtetit turk, si edhe ata të Institutit “Haxhi Bektash Veliut” pranë Universitetit të Gazit në Turqi. Gjithashtu, ka qenë i pranishëm dhe ka kontribuar me ligjëratat e tij në veprimtari analoge në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Ohër, Stamboll, Ankara, Afyon, Shtutgart Keln, dhe në



Detroit të SHBA-ve. Ka qenë pjesëmarrës në pelegrinazhin Botëror për Haxhillëk në Mekë, në vitin 2004. Merr pjesë në vizitat e vendeve të shenjta në Jeruzalem në Izrael, në vitin 2007. Ka qenë i ftuar në Kongresin e 33-të Botëror për “Liritë Fetare” në Indi dhe ka nderur pishtarin e këtij aktiviteti, së bashku





## Gëzuar ditëlindjen Dede Edmondi!

Engjëll MUSAI / Drejtor i Gazetës "Telegraf"

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mbush 63 vjeç. Kjo është një datë e shënuar për komunitetin bektashian dhe miliona bektashinj në mbarë botën, për klerikët e këtij besimi të paqtë, klerikë të besimeve të tjera, për grupime sociale e faktorë të tjerë shtetërorë e shoqërorë, që duan dhe janë angazhuar për dashuri, harmoni dhe paqe universale. Në këtë ditë të shënuar, këtyre

urimeve u bashkohet dhe ai i yni, i miqve të tij, kolegëve gazetarë, mik i të cilëve ai ka qenë dhe do të mbetet.

Në cilësitë e drejtorit të gazetës "Telegraf", kam kënaqësinë që në emër të gazetarëve të këtij organi e mijëra lexuesve të saj ta uroj: Gëzuar ditëlindjen Dede Edmond Brahimaj, dhe 100 të tjera! E me këtë rast, në respekt e si mik i yni i veçantë, këtë urim po ia përcjellim në këtë speciale në dy faqe të gazetës.



me udhëheqësin e shquar fetar, Dalai Lama. Ka marrë pjesë në tri konferenca Botërore mbi fenë në Maqedoni nga viti 2006-2011. Ai ka mbaruar studimet për Juristikën, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Maqedoni.

Pas kalimit nga jeta e ish-Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhit, baba Mondit, më 11.06.2011 zgjidhet në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Këto vite si Kryegjysh Botëror i Bektashinjve, Hirësia e

Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka punuar me përkushtim duke vazhduar rrugën e Dede Reshatit Bardhit, traditën bektashiane në marrëdhënie institucionale brenda dhe jashtë vendit. Ka pasuar gjatë kësaj periudhe drejtimi, një agjendë të ngjeshur në veprimtaritë e ndryshme ndërkombëtare nëpër botë. Në vendet e Ballkanit ka pasur mjaft takime me Presidentët e Kryeministrat e Turqisë, Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë, Greqisë, Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës etj.





**RUBRIKA:** HISTORIKU TETËSHEKULLOR I BEKTASHIZMIT NËPËRMJET FOTOVE



Baba Abedini i teqesë së Leskovikut, bashkë me dervishët e tij



Baba Bajram Gurakuqi ( i pari majtas) ardhur nga Amerika në Kosovë, në takim me baba Qazimin (në qendër) dhe klerikë të tjerë kosovarë


# FOTO HISTORI



Baba Rexhebi (në qendër), me dervishët, Gjirokastër, viti 1937.



Baba Shaban Prishtë.



Ibrahim Baba (1850-1935).






Dervish Rakipi, Golimbat.

**RUBRIKA E RE**

*Në revistën ‘Urtësia’, në çdo numër të saj do të botohen foto të panjohura apo dhe të rralla, të objekteve të kultit bektashian, të vendeve të shenjta si dhe të personaliteteve klerikë, baballarë e dervishë...*



Baba Seit Koka, Skrapar. Viti 1972.



Dervish Abdullah Dule Balili, Tiranë.



A. Dervish, viti 1930.




Baba Selimi. Gjirokastër, 1907.



Baba Arshiu.



Dervish Arshi Bazaj, viti 1930.



Dervish Murteza Kruja, viti 1939.

*Përgatit dhe punoi fotot:  
Nuri Çumani*





## Veprimtaritë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, gjatë muajve maj-qershor 2022

- \* 1 maj. Festë bektashiane në Volos-Greqi, me rastin e 542-vjetorit të themelimit të teqesë, "Durballi Sulltan".
- \* 2-3 maj. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në vlerësimin e disa personaliteteve të biznesit dhe administratës franceze. Aktivitetet i zhvilluar nga "Misioni Paqe dhe Zhvillim".
- \* 3 maj. Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond, merr pjesë dhe përshëndet në Asamblenë e Parë, "Himni i Paqes", në Teatrin "A. Z. Çajupi", Korçë.
- \* 5 Maj. Përkujtohet 110-vjetori i lindjes së Ibrahim Hasanajt.
- \* 7 maj, Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në inaugurimin e përmendores së Hasan Prishtinës, në qytetin e Vlorës.
- \* 10 maj, Java e Evropës 2022. Bashkimi Evropian në Shqipëri, shfaq premierën e dokumentarit "Dritë nga i njëjti zjarr", mbi diversitetin fetar në Shqipëri.
- \* 11 maj, gjashtëvjetori nga takimi me Papën e Romës në Vatikan, i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimajt.
- \* 11 maj. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj merr pjesë në prezantimin e librit të Shkrimtarit të njohur Jordan Pllevnesh, nga Maqedonia e Veriut.
- \* 12 maj. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj merr pjesë në ditën e pelegrinazhit në teqenë e Alipostivanit në Përmet dhe në shoqërimin e baba Hekuran Nikollarit drejton ritet tradicionale.
- \* 18 maj, Deutsche Welle - Gjermani: Delegacioni shqiptar përcjell shembullin e jetuar në shekuj të harmonisë fetare.
- \* 18 maj 2022. Në kuadër të aktivitetit "Harmonia Fetare dhe toleranca, një vlerë e shtuar shqiptare në Evropë", delegacioni shqiptar takon personalitete të ndryshëm në Gjermani.
- \* 18 maj, delegacioni shqiptar pritët nga drejtues të Bashkisë së Essenit, Gjermani.
- \* 19 maj, Ditën e enjte, 19 maj 2022. Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka 63-vjetorin e lindjes. Urime të shumta nga personalitete të vendit dhe të huaj, me këtë rast.
- \* 25 maj, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në "Forumit e Lirisë Ballkanike", me temë "Trendi aktual i trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkan".
- \* 26 maj. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në "Ditët naimjane", në Përmet (24 -25 maj).
- \* 28 Maj, Kavajë. 196-vjetori i teqesë "Baba Sako", në Luzi i Madh.
- \* 28 Maj. Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mesazh ngushëllimi për ndarjen nga jeta të ish-Presidentit, Bujar Nishani.
- \* 2 qershor. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në ceremoninë e lamtumirës, në nderim të ndarjes nga jeta, të ish-Presidentit, Bujar Nishani.
- \* 3 qershor. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, drejton disa aktivitete në nder të Dede Ahmetit.
- \* 4 qershor. Përkujtohet 12-vjetori i ngritjes së teqesë "Dede Reshat Bardhi", në Sarandë.
- \* 8 qershor. Zhvillohet pelegrinazhi tradicional, në teqenë e Qesarakës- Kolonjë.
- \* 11 qershor, 11-vjetori nga zgjedhja në postin e Kryegjyshit Botëror Bektashian, i Haxhi Dede Edmond Brahimajt.
- \* 15 qershor. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në pelegrinazhin tradicional në teqenë e Bubësit-Përmet.
- \* 19 qershor. Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në pelegrinazhin tradicional vjetor, në teqenë e Bllacës.
- \* 20 qershor. Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në pelegrinazhin tradicional në teqenë e Backës-Skrapar.
- \* 22 qershor. Gazetarë dhe studiues të njohur amerikanë, vizitajnë teqenë bektashiane të Gjakovës.
- \* 29 qershor. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në pelegrinazhin tradicional të Ballenjës, Martanesh.
- \* 30 qershor. Mesazh ngushëllimi i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, për ndarjen nga jeta të Tomorr Alikos, ish-Sekretarit të Përgjithshëm të Selisë së Shenjtë Bektashiane (1993-1995).





## **GJASHTË VJET NGA TAKIMI NË VATIKAN, I KRYEGJYSHIT BOTËROR BEKTASHIAN, DEDE EDMOND BRAHIMAJT, ME PAPËN E ROMËS**

*Gazetari i mirënjohur Ferdinand Samarxhi, "Nderi i Kombit":*

*Iu rrëfej takimin e Kryegjyshit Botëror, Dede Edmond Brahimaj, me Papa Françeskun në Vatikan, mesazhet dhe intervistën e rrallë me atin e Shenjtë, që theu rregullat e protokollit zyrtar*

*Nga Nuri ÇUNI*

*Sekretar i Përgjithshëm i Kryegjyshit Botëror Bektashian*





**M**ë 11 maj 2022, kur mbushen plot 6 vite nga takimi në Vatikan, i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Dede Edmond Brahimajt, me Papën e Romës, gazetari i njohur, Ferdinand Samarxhiu, që ishte moderator i takimit dhe gazetari që theu protokollin e Vatikanit, duke i marrë intervistë Atit të Shenjtë, mes emocioneve që siç thotë ai “nuk kanë vdekje kurrë”, rrëfen për “Urtësia”, disa detaje interesante nga ai takim dhe mesazhet që dha. “... Kam qenë me fat që isha gazetari i vetëm televiziv nga Shqipëria që isha pjesëmarrës (bashkë me operatorin), moderova atë dhe arrita që me mikrofon, t’i marr intervistë Atit të Shenjtë, rast i paprecedent ky sipas protokollit, por që u pranua nga mikpritësi. Ishte fat për mua prania në këtë pritje vëllazërore, Kryegjyshi Botëror Bektashian-Papa i Romës... Vlerësimet dhe mesazhet që dhanë dy liderët, janë aktuale dhe për sot e në vijimësi. Kam shumë mbresa e detaje të atyre dy ditëve në Vatikan (megjithëse kisha qenë dhe herë tjetër e kisha takuar Papën paraardhës), kam shkruar diçka, por me kënaqësi po rendis disa kujtime për ju, sot që është 6-vjetori i këtij takimi”.

#### **Përgatitja dhe emocionet para takimit**

Siç e kam thënë, ishte një vizitë dyditore historike, me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi ishte hera e parë që një Papë priste në Selinë e Vatikanit

një lider fetar shqiptar. Nuk mund ta harroj atë ditë, emocionet e papërsëritshme të saj. 11 maj, ora 09:00, do të mbetet orë e përjetimit të një takimi historik me përmasa dhe konture që do të rriten gjithnjë e më shumë, çdo ditë e më tepër në horizont. Vizioni i atij takimi do të ndriçojë dhe do të bëhet më domethënës në vijimësi për paqen, dashurinë, për besimin, për rrugën e Zotit, për kombin, për shoqërinë e sotme njerëzore. Unë kisha vajtur dhe më parë në Vatikan, por duke qenë se në këtë takim, isha njëkohësisht moderator i tij dhe i vetmi gazetar shqiptar televiziv, që kisha privilegjin të futesha në këtë takim me operator, të filmoja. Ndërsa këmbëngulja ime për t’i marrë dhe një intervistë Papës, (gjë e cila ishte jashtë protokollit), gatishmëria e Papës dhe realizimi i saj, ishte një gjë e rrallë e privilegj. Dua të kujtoj këtu se, unë isha përgatitur mirë për këtë takim (fat dhe ëndërr për çdo gazetar), ku kameraman kisha të mirënjohurin e TVSH, Naum Laskun, pra atë që kishte filmuar Papa Gjon Palin dhe Papa Françeskun. E falënderoj me zemër atë.

#### **Takimi i Papës me Dede Mondin**

Ora 09:00 e 11 majit 2016, na gjeti në pikun e emocioneve të pritjes së Papës. Ati i Shenjtë futet në derë, na shikon e buzëqesh, teksa ne, përulemi me nderim dhe respekt. Gjatë ecjes, pohoi se “Pres një mik të mirë nga Shqipëria!”. Në respekt të Dede Edmond Brahimajt dhe delegacionit shqiptar, Ati i





Shenjtë nuk shkoi te fronti i tij ku sipas protokollit strikt, rri gjithnjë, por mori karrigen e Tij, e tërhoqi, (edhe pse të tjerët kërkuan ta ndihmojnë me urgjencë) dhe u afrua e u ul pranë Kryegjyshit Botëror, për të treguar një afërsi vëllazërore të një takimi tejet të përzemërt. Pas prezantimit të delegacionit nga Kryegjyshi Botëror, Papa dëgjoi Kardinalin Turanë, Kryetarin e Këshillit Papnor të dialogut Ndërfetar të botës, i cili i tregoi Papës për rolin e komunitetit bektashian, si një faktor i madh, aktiv, në harmoninë, tolerancën dhe mirëkuptimin fetar, rolit dhe angazhimit të bektashizmit për paqen dhe bashkëjetesën vëllazërore mes njerëzve në shoqëri. Kam fiksuar mirë se në këtë moment, Papa, i prekur thellë, nga ardhja e takimi me mikun e shtrenjtë, një vëlla i thjeshtë i Dedeit tonë, të së njëjtës familje të Zotit, u ul me karrigen pranë Tij, dhe si vëllai me vëllanë, fare pranë me njëri-tjetrin, *kujtoj mbresat e pashlyeshme që ruaj, – tha Ati i Shenjtë, – në mendje dhe në zemër, nga takimi me popullin shqiptar. Kujtoj rininë, –tha Ati i Shenjtë– si vlerë e një kombi për të sotmen dhe të ardhmen e shoqërisë. Në të kaluarën, – tha Ati i Shenjtë, – kemi bërë luftëra mes besimeve, duhet të pendohemi për to, por nuk është lufta rruga në të cilën duhet të ecim. Rruga që duhet të përshkujmë është ajo e dashurisë, e paqes, e dialogut dhe e mirëkuptimit midis feve, vendeve, popujve e shoqërisë së sotme njerëzore.* Papa theksoi gjithashtu, vlerat e bashkëjetesës vëllazërore, ndërmjet besimeve

meve që ekzistojnë në Shqipëri, si një shembull e thesarit çmuar i kombit shqiptar, vlera këto që duhet të kultivohen e të çohen përpara me përkushtim e bindje. Ati i Shenjtë kujtoi takimin e Tij me krerët e komuniteteve fetare në Tiranë, e inkurajoi këtë harmoni vëllazërore, dhe kjo të përhapet si një dritë e pashuar gjithmonë.

### **Bisedë vëllazërore e dy liderëve**

Sjellja e veçantë, respekti që tregoi Papa që në hyrje, gjatë bisedës dhe fjalët e ngrohta që shprehu, mënyra e komunikimit tejet vëllazëror me Kryegjyshin Botëror, na i shkriu ‘akujt’ e emocioneve, duke krijuar një mjedis të papërsëritshëm miqësor. Dede Edmond Brahimaj, duke falënderuar Atin e Shenjtë, për pritjen që i rezervoi, për ngrohtësinë që i afroi dhe për fjalët e përzemërta që përçoi për kombin tonë, i tha ndër të tjera: “...Ju jemi mirënjohës për gjithë jetën për atë çka po bëni për bijtë e kombit tonë, për shenjtërimin e Nënë Terezës, për lumturimin e 38 Martirëve që u persekutuan në mënyrë çnjerëzore nga regjimi ateist komunist. Ne dhe gjithë bota, duhet t’u jemi mirënjohës për mesazhin e madh që Ju përcollët, për gjithë njerëzit e vuajtur, emigrantët myslimanë, që kërkuat që shtetet jo vetëm të hapnin kufijtë, por të hapnin dhe dyert e shpirtit për ta”. Po ashtu, Kryegjyshi e falënderoi Papën për punën që po bën për të shmangur luftërat në emër

**VIJON NË FAQEN 24 >>**





të Zotit e të fesë, e për t'i afruar popujt e fetë mes tyre, si një familje e vetme njerëzore. “Pikërisht këto vlera, ne i manifestuam, me pjesëmarrjen tonë në Paris, pas atentateve terroriste. Ne jemi bashkuar të gjithë vëllezërit myslimanë në Ballkan e më gjerë, në luftë kundër rrymave të ndryshme radikale terroriste. ...Ne duhet të jemi gjithmonë në krahun tuaj, në krah të mesazheve të mëdha tuaja të paqes. Ne ju shohim gjithmonë ju si flamurtarë të dashurisë e paqes për popujt dhe fetë e ndryshme”. Pa u ndjejë, koha ecte, duke kaluar ndjeshëm limitin e kohës së caktuar në protokoll, për këtë takim. Në fund të tij, të dy liderët, të emocionuar nga ngrohtësia e vëllezërisë së tyre, në një moment mbetën dhe, veç përçafimi ishte ai që do ta mbyllte atë ngrohtësi, atë dashuri, atë veneracion që përshkoi bisedën e paharruar historike, një bashkim shpirtëror.

**‘Shkelja’ e protokollit dhe intervista ime me Papën**

E kam thënë e shkruar diku, rastin fatlum, (falë kryeneçsisë sime) për çdo gazetar të botës, dhënia e intervistës nga Papa, gjë që ishte kategorikisht e ndaluar nga protokollin, që e cila, në fund më lumturoi me praninë dhe falënderimet e Atit të Shenjtë. Por po përsëris diçka... Edhe pse e dija dhe e njihja mirë protokollin, edhe pse m'u dha një shans për t'u takuar me Papën e Romës, dhe unë duhej ta zbatoja me rreptësinë më të madhe, i entuziazmuar se çka kishte ndodhur në atë sallë, që ishin thyer rregullat e protokollit qindravjeçar, duke parë ngrohtësinë, afrimin, dashurinë që

unë në moment i quajta: bashkim i madh shpirtëror, mora guxim dhe iu drejtova Atit të Shenjtë me mikrofon dhe i thashë: ‘Ati i Shenjtë, një bekim për popullin tim shqiptar!’. Dhe Ati i Shenjtë, pohoi edhe një herë me atë dashuri e atë bekim të madh, për popullin tonë, që Shqipëria të ecë përpara, që kombi shqiptar gjithnjë e më shumë ta shohë veten nga e ardhmja më e mirë, që paqja dhe dashuria të mbizotërojnë mes tyre, si shqiponja në flamurin e kombit tonë. Kisha fituar gjithë botën, kisha marrë me vete gjënë më të shenjtë për vendin tim, për kombin tim, bekimin e Atit të Shenjtë! Kjo mua më lumturoi dhe do ta kujtoj gjithë jetën time, në zemrën time.

Sapo takimi përfundoi, Radio Vatikani e përcolli menjëherë në të gjitha gjuhët e botës. Ekranet e Shqipërisë filluan të informojnë dhe të buçasin, “Takim i rrallë historik!”. Por surprizat në Vatikan, vazhduan më tej. Kryegjyshi Botëror u ftua në Radio Vatikanin nga drejtori i saj, nga shqiptari Dom David Xhuxha.



**Mesazhe që janë gjithmonë udhërrëfim**

Takimi në Vatikan, i Kryegjyshit Botëror Bektashian, me Papën e Romës, biseda dhe mesazhet e këtij takimi, janë aktuale sot e në çdo kohë. Veçanërisht, në këto ditë e kohë të trazura që po kalojmë sot, ku jetë të pafajshme humbasin çdo ditë në luftën në Ukrainë, ku në shumë vende ka konflikte të mprehta dhe njerëzimi po përjeton vështirësi sociale.



## INTERVISTË E DHËNË PËR DW

# Dede Edmond Brahimaj në Gjermani, në seminarin për tolerancën dhe harmoninë fetare:

*“Dashuria dhe paqja është lumturia jonë, lumturi tjetër nuk ka!”*



Nga Ina VERBICA

**D**isa përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare vizituan Gjermaninë, në datat 18-20 maj 2022. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve, flet për DW mbi rezonancën e tolerancës fetare ndër shqiptarët.

**DW:** *Për katër ditë me radhë, ju promovuat në përbërje të delegacionit ndërjetar nga Shqipëria në landin gjerman të Renanisë Veriore – Vestfalisë tolerancën dhe harmoninë fetare si vlerë të shtuar të popullit shqiptar? Çfarë rezonance pati kjo përvojë shqiptare?*

**-Dede Edmond Brahimaj:** Gjermanët janë një popull me kulturë, këtë e treguan nga mikpritja, që na dhuruan në të gjitha takimet tona, na respektuan duke filluar nga personalitetet, por edhe nga populli gjerman, me shumë respekt, me shumë dashuri, plus edhe shqiptarët që punojnë këtu, që janë një pjesë e integruar në Gjermani, punojnë me ndershmëri dhe kjo është një gjë e mirë, që ne shohim në këtë shtet të bekuar, i cili është lokomotiva e Evropës. Dhe kjo ardhja dhe pritja jonë këtu ka vlerë për kombin tonë,

[VIJON NË FAQEN 26 >>](#)





Fotot nga aktiviteti në Gjermani

që ata të krijojnë një përshtypje të mirë për kombin shqiptar. Kjo është e rëndësishme për ne.

***Nga se mund të kërcënohet toleranca fetare, a ka rrezik të lëkundet kjo harmoni?***

-Nuk ka rrezik, se shqiptarët janë një dhe duke qenë një pavarësisht se mund të vijnë rryma të ndryshme në Shqipëri, siç kanë ardhur, por nuk e kanë gjetur atë shtratin e ngrohtë për të vepruar në kundërshtim të rregullave njerëzore. Kjo është një meritë e të gjithë

neve dhe e të gjithë kombit shqiptar. Pra, bashkërisht e kemi ruajtur këtë mrekulli të shqiptarëve.

***Për dekada në Shqipëri pati ndalim të besimit, atëzëim të imponuar nga regjimi komunist. A ka ndikuar ky fakt në tolerancën fetare?***

-Ajo ndihmoi për këtë unitet, që kanë shqiptarët mes besimeve, nuk i prishi punë.

Tani është kthyer liria e besimit dhe të jetuarit bashkërisht vazhdon.







Edhe tani ne vazhdojmë të marthemi me njeri-tjetrin. Në një familje ka katër besime.

***A sjell largimin e pjesëtarëve e besimeve të ndryshme prej njëri-tjetrit, thellimi në praktikimin e fesë së vet?***

-Absolutisht jo, rrymat ekstreme kanë ekzistuar dhe nuk kanë gjetur shtrat në Shqipëri. Mbesën time e kam ortodokse, çfarë t'i them, se jam unë më i mirë. Njeriu është i lirë të zgjedhë edhe para Zotit edhe para

ligjit. Të gjithë besojmë te Zoti. A zgjedh Krishtin apo Muhametin, ajo është e drejta jote. Mirëpo shqiptarët duhet të kenë një gjë parasysh, duhet t'i kthehen punës, e dyta të merren me veten, jo me komshiuin ose me tjetrin, siç themi ne. Duhet të interesohem, se çfarë bën familja ime, çfarë bëj unë personalisht. Përmirë dhe motoja jonë është, që të mos jemi asnjëherë në krahun e së keqes, por përherë në krahun e së mirës, dashurisë e paqes. Sepse dashuria dhe paqja është lumturia jonë, lumturi tjetër nuk ka.





# Nga Divani Ali

(Vijon nga numri i kaluar)

- ◆ Po t'ia plotësojë Zoti mendjen njeriut, i ka plotësuar Muradin dhe të gjitha nevojat që ka.
- ◆ Njeriun e mban të gjallë në shoqëri mendja, dhe me anën e saj përfiton diturinë dhe provat e jetës.
- ◆ Mendja e shëndoshë e zbukuron njeriun në jetën shoqërore, qoftë edhe sikur ky jetesën e tij ta sigurojë me fitime të kufizuara.
- ◆ Njeriun e diskrediton në jetë mendja e shkurtër dhe sikur të rrjedhë nga një familje fisnike.
- ◆ Sado superior dhe triumfues të jetë njeriu me anën e mendjes e të trimërisë, në punën e jetesës, nga ndonjëherë triumfon ai që e ndihmon fati.
- ◆ Nuk është për t'u çuditur në qoftë se njeriu pëson ndonjë fatkeqësi në ditët tona, por çudia më e madhe është të shpëtosh prej saj.
- ◆ Nuk është bukuri stolia me veshje e me sende të çmuara, por njeriun e zbukuron stolia e edukatës dhe e diturisë.
- ◆ Nuk është jetim ai që nuk ka prind, por jetim quhet ai që nuk ka mend dhe edukatë.
- ◆ Ji i biri i kujt do qofsh, mundohu të përfitosh edukatën, sepse atëherë nuk mbetet nevojë të përmendet fisi yt.
- ◆ S'mund të quhet fisnik njeriu, po nuk pati edukatë dhe gjuhë të ëmbël.
- ◆ Burrë është ai që e paraqet veten në mënyrë të thjeshtë e jo ai që paraqitet në emrin e të atit.
- ◆ O ti injorant që mburresh me fisin tënd, a nuk e di ti se njerëzit origjinën e tyre e kanë prej një nëne e prej një babe.
- ◆ A sheh njeri që të jetë krijuar prej hekuri, bakri, sermi dhe floriri?
- ◆ A ke parë njeri që në formacionin e tij të ketë gjëra të çmuara si këto, veç: mishit, kockave dhe nervave?
- ◆ Mburrja u takon vetëm atyre që kanë mendje të qëndrueshme, turp, nder dhe edukatë të mirë.
- ◆ Jam munduar natë e ditë për ta edukuar veten time dhe, nuk gjeta edukatë më të mirë përveç mbështetjes te Zoti dhe aplikimin e urdhrave të tij.
- ◆ Kur unë në edukimin e vetes, konstatoj të metat e



mia, i pranoj këto duke mbyllur gojën. Heshtjen në këtë pikë e quaj një edukatë dhe më të preferuar se sa të gënjej.

- ◆ Zoti i madhëruar e ka ndaluar rreptësisht në Kuran ta shash njeriun mbas shpine kur nuk është prezent.
- ◆ Në qoftë se fjala është serm', o ti shpirti im, heshtja është flori.
- ◆ I ndershëm quhet ai që rezervohet të nxjerri fjalë të liga nga goja dhe në takimet që ka me njerëzinë sillet butë.

**Sqarim:** Këshilla e sipërme i përshtatet dhe verasetit Kuranor që thotë: “Mbi tokë bëhen objekt fyerje nga injorantët, nuk zemërohen dhe ju përgjigjen me fjalë të ëmbla”.

VIJON NË FAQEN 28 >>



- ◆ Ai që respekton njerëzit e merituar, nderohet, dhe kush i diskrediton, nuk lavdërohet.
- ◆ Kur ballafaqohem me një të paedukuar, dhe ky më drejton fjalë të liga, Unë i sillem urtë dhe neveritem t'i përgjigjem.
- ◆ Duke mos denjuar t'i jap përgjigje të paedukuarit, atij i mbetet poshtërsia, dhe mua më shtohet urtësia si druri i Udit që kur digjet, i ndihet era e mirë.
- ◆ Vërja në dukje rrobën e turpeve që ka veshur bash-fetari yt, dhe bëhu mbulues për fajet e tija.
- ◆ Duroje padrejtësinë që të bën i paedukuari dhe shpagimin lërja kohës, se me ndërrimin e saj, zhduket dhe dhuna e tij.
- ◆ Mos u kujdeso t'i përgjigjesh të paedukuarit, sillu me të mirë dhe hakmarrjen lërja Zotit.
- ◆ Vajti besa siç kaloi dita e djeshme, dhe njerëzia vërtiten në mes të intrigës dhe të interesit.
- ◆ Në dukje i shfaqin dashuri e sinqeritet njëri-tjetrit, kurse zemrat e tyre janë bërë fole akrepash.
- ◆ Dituria m'u zmadhua dhe vetitë i kam të pastra, si mund të bëhet një njeri i pajisur me këto cilësi të vuajtjes? Këtë nuk e kuptoj.
- ◆ Po të kërkoj një miq, mund t'i gjeja; por si të kërkoj një mik të sinqertë, nuk e gjej dot, edhe këtë s'e kuptoj.
- ◆ O Zot më bëj të fortë dhe të qëndruar që të mos shkas si këmba, dhe zemrën ta kem të pa tronditur në rrugën tënde, se mbështetjen e kam vetëm tek Ti. Unë u zhvesha nga të gjitha të metat, bujaria jote më mjafton për çdo nevojë që kam.
- ◆ Zemra m'u plagos nga dhimbja e fajeve të mia dhe nga të qarit me dënësë.
- ◆ Nga pagjumësia që më shkaktoi kjo sëmundje, trupi im delikat m'u tha dhe m'u bë si shkop.
- ◆ Frika e madhe ia ndërroi ngjyrën frikës sime kur më erdhën fatkeqësitë njëra pas tjetrës.
- ◆ Thërres e lutem me përlulje o Zot, m'i fal mëkatet dhe m'i mbulo turpet.
- ◆ I bëra thirrje me dhembje gjithë njerëzisë për shërimin e plagës sime, po nuk pashë njeri të më përgjigjet.
- ◆ O Zot i madhëruar, Ti je ai që ia pranon lutjet dhe ia largon hidhërimet njerëzisë.
- ◆ Sëmundja ime është e brendshme dhe shërimi i saj është tek Ti, prandaj nuk ka mjek tjetër veç teje, o i dashuri im.
- ◆ Po të duash që ta pakësosh dashurinë, bëj vizita të

shpeshta dhe po deshe që ta shtosh, rrallo vizitat e tua.

**Sqarim:** Në lidhje me këtë është dhe fjala Profetike që thotë: “Rrallo vizitat që të shtosh dashurinë”.

- ◆ Sa i mirë është shoqërimi kur bëhet rrallë, se përsëritja shkakton prishje.
- ◆ Priti thonjtë sipas zakonit të Profetit dhe siç e kërkon edukata. Thonjtë e dorës së djathtë prit sipas shkronjave Arabe. Havabet e dorës së majtë sipas germave Ev-haseb.

**Sqarim:** Prerja e thonjve të dorës së djathtë sipas rregullit Havabes bëhet kështu: Më së pari, prerja fillon nga gishti i vogël, pastaj duke lënë të dytin pranë këtij, pritet i mesmi, dhe pastaj duke lënë të katërtin, pritet i madhi; pas këtij pritet i dyti pranë të voglit, dhe më në fund i katërti që është afër të madhit, i cili quhet gishti i dëshmisë. Prerja e thonjve të dorës së majtë sipas rregullit Evhaseb, bëhet në këtë mënyrë: I pari gishti i madh, i dyti gishti i mesëm, i treti gishti i vogël, i katërti gishti i dëshmisë dhe i pesti, gishti afër të voglit.

- ◆ Çuditë me ata që nuk kanë durim, dhe qajnë e vajtojnë kur i godet ndonjë fatkeqësi në rrethin e tyre.
- ◆ Disa njerëz që e shikojnë jetën nga pikëpamja materiale, dhe nuk e çojnë ndër mend fare vdekjen; kur ju ngjan ndonjë vdekje, habiten e çirren e qajnë me injorancë.
- ◆ Zoti e krijoi njerëzinë të njëjtë duke e pasur secili vdekjen mbi kokë; bile as Profetët e Tij nuk i përjashtoi nga vdekja.
- ◆ Zoti ka një engjëll që e thërret çdo ditë, i urdhëruar prej Tij; lindni për të vdekur dhe ndërtoni për të shkatërruar.

**Sqarim:** Në lidhje me fjalën e sipërme, është dhe një tregim i marrë nga libri Thaelebiut, që thotë: “Në kohën e Profetit Sulejman, kur ai ndërtoi pallatin më të madh të asaj kohe, i erdhi një pëllumb dhe i këndoi këto fjalë në gjuhën e tij: “Lindni për të vdekur dhe ndërtoni për t'u shkatërruar””.

Në lidhje mbi sa u tha më sipër, kemi dhe fjalën Profetike të Hazretit Muhammed e thënë prej shokut të tij Ebu-Dheri Gifariut: “Lindni për të vdekur dhe ndërtoni për t'u shkatërruar”.

*(Vijon në numrin e ardhshëm)*



# Nga Kurani Qerim

(Vijon nga numri i kaluar)

## SURETU EL BEKARE

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

-Ju u pat ardhur Musai me argumente, por pas tij ju adhuroat vëçin, pra ju ishit mizorë.\*

(përkujtoni). Kur morëm premtimin tuaj dhe mbi ju ngritëm kodrën Tur, (u thamë) merrni këtë që u dhamë seriozisht dhe dëgjoni (respekttoni). Ata thanë: “Dëgjuam (me vesh) e kundërshtuam”. E për shkak të mosbesimit të tyre, adhurimi ndaj vëçit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre. Thuaj: “Nëse jeni besimtarë, besimi juaj është duke u udhëzuar keq”.

-Thuaj: “Nëse bota tjetër (xhenneti) tek Allahu është vetëm për ju, e jo edhe për njerëzit e tjerë, nëse jeni të sinqertë, kërkoni vdekjen (e shikoni më shpejt).

-E për shkak të veprave të tyre (mëkateve), ata kurrë nuk e dëshirojnë atë . Allahu di për zullumqarët.

-Është e sigurt se njerëzit më lakmues për të jetuar, ti ke për të gjetur ata (jehuditë),

bile edhe më lakmues se idhujtarët. Ndonjëri prej tyre dëshiron të jetojë një mijë vjet, por edhe sikur të jetojë, ajo (jeta e gjatë) nuk do ta shpëtojë atë prej dënimit. Allahu sheh çka veprojnë ata.

-Thuaj: “Kush është armik i Xhebrilit (është armik i Allahut), e ai me urdhrin e Allahut, e zbriti Kuranin në zemrën tënde, që është vërtetues i asaj që ishte më parë dhe udhërrëfyes e përgëzues për besimtarët.

-Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit (ai është mosbesimtar), Allahu padyshim është armik i mosbesimtarëve.

-Ne të kemi shpallur ty (Muhammed) argumente të qarta dhe ato nuk i mohon askush, përveç atyre që kanë dalë respektit.

-(Nuk besojnë argumentet tona se) Sa herë që ata kanë dhënë ndonjë premtim, një grup prej tyre e hodhi atë, por shumica e tyre nuk e beson.

-Edhe kur u erdhi atyre ndonjë i dërguar prej Allahut, vërtetues i asaj që e kishin ata, një grup prej tyre të cilëve iu kishte dhënë libri, e hodhi pas shpine, librin e Allahut, kinse nuk dinin (asgjë).

-(E hodhën librin e Zotit). E ndoqën atë, që ato që e thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafe, por djajtë ishin të

pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti Zoti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pafë!” E mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e Allahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe

ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata për çka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.

-E sikur të kishin besuar ata edhe sikur të ishin ruajtur (prej mëkateve), po të dinin, shpërblimi prej Allahut do të ishte shumë më i dobishëm.\*

-O ju që keni besuar, mos thuani: “Raina”- po thuani: “undhurna” dhe respekttoni! Mosbesimtarët kanë dënim të dhembshëm.

-As ata, ishtarët e librit që nuk besuan, e as idhu-





jtaret që nuk duan që juve të ju vij ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Mirëpo, Allahu me mëshirën e vet, veçon atë që dëshiron. Allahu është zot i mirësisë së madhe.

-Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhin në harresë e të mos sjellim dhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send?

-A nuk e ke ditur se vetëm Allahu i takon sundimi i qiejve e i tokës, dhe se pos Allahut nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar.

-A doni të pyetni të dërguarin tuaj sikurse u pyet më parë Musai. Ai që e ndërron besimin në mosbesim, ai tanimë ka humbur në rrugën e drejtë.

-Shumë ithtarë të librit (Jehudi, krishterë), edhe pasiqë iu është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë, pra ju lini dhe largohuni prej tyre derisa Allahu ta sjellë urdhrin e vet. Allahu ka mundësi për çdo send.

-Kryeni faljen (namazin) dhe jepni zeqatin, e çfarëdo të mirë që e përgatitni për veten tuaj, e atë e gjeni tek Allahu. S'ka dyshim se Allahu përcjell çdo veprim tuajin.

-Ata edhe thanë: "Kursesit nuk ka për të hyrë kush në xhennet, përveç atij që është Jehudi ose i krishterë! Ato janë fantazi e tyre! Thuaju: "Sillni argumentin tuaj (çka thoni) po qe se jeni të drejtë?"

-Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë përse të mërziten.

-Jehuditë thanë se të krishterët nuk janë të mbështetur në asgjë (nuk kanë fe të vërtetë). Edhe të krishterët thanë se jehuditë nuk janë të mbështetur në asgjë, e duke qenë se ata të dy palët lexojnë librin. Po kështu si thënie e tyre, thanë edhe ata që nuk dinin (idhujtarët për Muhammedin). Po në ditën e gjykimit për atë që ato nuk pajtoheshin, Allahu gjykon ndërmjet tyre.

-E kush mundet të jetë më mizor se ai që në xhamitë e Allahut pengon të përmendet emri i Tij (të bëhet ibadet) dhe përpiket për shkatërrimin e tyre. Atyre ndryshe nuk u takoi të hyjnë vetë në to, vetëm duke qenë respektues (të tyre e jo rrënues). Ata në këtë jetë kanë nënçmim e në botën tjetër dënim të madh.

-Të Allahut janë edhe (anët nga ) lindja edhe perëndimi, dhe kahdo që të ktheheni, aty është anë

e Allahut. Vërtetë, Allahu është i gjerë (në bujari) e i dijshtëm.\*

-Ata (ithtarët e librit) thanë: "Allahu ka fëmijë"! I pastër është Ai nga kjo e metë! E Tij është gjithçka në qiej dhe në tokë, gjithçka i është nënshtruar Atij.

-Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm thotë: "Behu!" në atë moment bëhet.

-E ata që nuk e dinë (kureshinjtët politetistë) thanë: "Përse të mos na flasë neve Allahu, ose të na vijë ndonjë argument!" Po kështu, thënie e tyre në mënyrë të njëjtë i patëm përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemra e tyre. Ne tanimë sqaruam argumentet për një popull që dëshiron të bindet.

-Ne të dërguam ty me të vërtetën (me Kur'anin), përgëzues dhe qortues, e ti nuk je përgjegjës për banuesit e xhehenemit.

-As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri që të pasosh fenë e tyre.

Thuaju: "Udhëzimi i Allahut është udhëzimi i drejtë. E nëse pasiqë të ka ardhur ty e vërteta, shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu.

-Atyre, të cilëve u dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejtë ashtu si është, ata e besojnë atë (Kur'anin). E ata që e mohojnë atë, të tillët janë ata që dështuan (në dynja e në ahiret).

-O bijtë e israilit, kujtoni të mirat e Mia që ua dhurova, që ju dallova mbi njerëzit (të asaj kohe).

-Dhe ruajuni një ditë kur askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asnjë send, nuk pranohet prej askujt kompensim, nuk do t'i bëjë dobi askujt ndonjë ndërmjetësim dhe as që do të ndihmohen (mëkatarët)\*

-Përkujto (O i dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: "Unë po të bëj ty prijës (imam) të njerëzimit!". Ai tha: "(bën o Zot) Edhe nga pasardhësit e mi!" (Zoti) Tha: Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!"

**(Përkthim pas vitit 1990)**

**-Vijon në numrin e ardhshëm-**

## SHËNIM:

Në numrat në vijim,  
në revistë do të botohen  
pjesë të tjera nga Kurani.





## Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në ceremoninë e lamtumirës, në nderim të ish-Presidentit, Bujar Nishani

**D**itën e enjte, më datë 2 qershor 2022, në Tiranë, u mbajt me nderime të larta shtetërore, ceremonia e homazheve në nderim të ish-Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, i cili ndërroi jetë në moshën 56-vjeçare.

Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, e shpalli 2 qershorin, ditë zie kombëtare në nderim të ish-Presidentit Nishani, ndërkohë ceremonia e homazheve u mbajt në ambientet e Presidencës së Shqipërisë.

Pjesë e homazheve ishin edhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj; Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta; Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani; Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla; ministra, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe zyrtarë dhe personalitete të ndryshme nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe vende të tjera.

Pas ceremonisë, trupi i pajetë i ish-Presidentit Nishani është përcjellë me nderime të larta shtetërore, për në banesën e fundit.

Kujtojmë se, Nishani ndërroi jetë në Gjermani më 28 maj, ku ishte i shtruar prej disa javësh në një spital, për shkak të problemeve nga një infeksion pulmonar dhe problemeve të tjera shëndetësore.



Bujar Nishani, u lind më 29 shtator 1966, në qytetin e Durrësit. Studimet e larta i kreu në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë dhe për Jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Karriera politike e ish-Presidentit Nishani, ka kaluar në disa etapa në Partinë Demokratike të Shqipërisë, si dhe në institucionet e vendit.

Përveç postit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vitet 2012-2017, Nishani, ka mbajtur edhe postin e ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Drejtësisë, të Shqipërisë.

*Korresp., “Urtësia”*



# Ndahet nga jeta, Tomorr Aliko, ish-Sekretari i Përgjithshëm i Selisë së Shenjtë Bektashiane

**K**ryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, nëpërmjet një mesazhi, ngushëllon familjarët, miqtë e shokët e myhibit Tomorr Aliko, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Kryegjyshit Botëror Bektashian në periudhën 1993- 1994, që u nda nga jeta më 29 qershor 2022, në moshën 97-vjeçare, Tomorr Aliko.

Në mesazhin e Dede Edmond Brahimajt, ndër të tjera thuhet: “Mësuam lajmin e hidhur dhe shprehim ngushëllimet tona, për kalimin nga kjo jetë, të Tomorr Alikos, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Kryegjyshit Botëror Bektashian, në vitet 1993-1994. Jeta e Tomorr Alikos, ish-i burgosur politik antikomunist, nacionalist i spikatur, ish-kryetar i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, shkrimtar, skenarist, aktivisti i shquar i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, është një histori përpjekjesh, sakrificash e qëndrese të spikatur. Ai lindi më 10 korrik të vitit 1925, në Libohovë, të Gjirokastrës. Në moshën 17-vjeçare aderoi në Ballin Kombëtar. Në vitin 1945 u arratis në Greqi, ku u inkuadrua në forcat Aleate. Pas gjashtë muajsh, u kap në kufi. Më 9 dhjetor të vitit 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës, e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për “Dhënie informacioni të huajve kundër shtetit”. Pas kryerjes së dënimit, u internua për 29 vjet në Mamurras. U lirua në vitin 1991. Aliko është autor i disa librave, filmave dokumentarë dhe shumë artikuj e intervista në media, ku përmendim: “Fund i udhës së gjatë” (1999); “Gjysmë shekull në kthetrat e djallit” (Tiranë, 2003); “Gjenocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist” (Tiranë, 2007); “Gjenocidi gjysmëshekullor në Shqipëri” (“Emal”, Tiranë, 2010). Tomorr Alikoja është dhe autor i skenarit të filmit dokumentar “Zhdukja e inteligjencës shqiptare gjatë viteve 1944-1951”, prodhim i Televizionit Publik Shqiptar (2008). Ai dha ndihmesë për bektashizmin, si një veprimtar aktiv në përgatitjen e disa ekspozita fotografike mbi bektashizmin dhe botoi librin: “Rilindja



Tomorr Aliko

e Bektashizmit në Shqipëri”, Tiranë, 2004; filmin dokumentar “Bektashizmi në Shqipëri” etj. Ai ishte muhib, ka marrë dorë nga Kryegjyshi Dede Reshat Bardhi, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Kryegjyshit Botëror Bektashian në vitet 1993- 1995. Po ashtu, ai ndihmoi në përgatitjen e Kongresit VI bektashian në korrik 1993, si dhe në organizimin e rihapjen e teqeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Ngushëllimet të sinqerta familjes! Nderim përjetë veprës dhe sakrificës së tij! Qoftë i Xhenetit!”. Varrimi i Alikos, u bë më 30.06, në vendlindjen e tij, në Libohovë.

Korresp., “Urtësia”





## Gazetarë e studiues të njohur amerikanë, vizitojnë teqenë bektashiane të Gjakovës

**Lorik BAKIA**  
*Gazetar, Prishtinë*

**H**istoria tetëshekullore e besimit të paqtë bektashian, trashëgimia shpirtërore e kulturore e tij, predikimi për paqe, bashkëjetesë ndërfaqetare e harmoni, adhurimi në Zot dhe dashuria vëllazërore pa dallim besimi fetar, etnie, race e ngjyre, përherë e më shumë por gjen mbështetje, duke ngjallë dhe interesin e

studiuesve të njohur botërorë. Kështu, dhe historia dhe trashëgimia bektashiane në trevat shqiptare, përherë ka tërhequr vëmendje mbarëkombëtare. Ndër dekada, teqetë bektashiane kanë qenë vatra mikpritjeje për studiues të ndryshëm, por edhe gazetarë të shumtë. Interesim të madh, sikur në të kaluarën, ashtu dhe sot, zgjon parimi bektashian për të grumbulluar dije, për ta arkivuar atë në biblioteka e arkiv, për ta ruajtur për gjeneratat e ardhshme dhe për ta shpërndarë sa herë të ketë nevojë.







Të martën e tretë të qershorit 2022, Teqenë Bektashiane të Gjakovës e vizitoi gazetarja amerikane Nina Stochlic, nga media e njohur ndërkombëtarisht, 'National Geographic'. Ajo ishte e shoqëruar nga profesori universitar e studiuesi, Prof. Dr. Nehat Krasniqi. Vizitorët u pritën sipas traditës, me dashamirësinë e dervishit të Teqesë së Gjakovës, Dervish Rrauf Radoniqi, i cili iu transmetoi miqve përkujdesjen e Selisë së Shenjtë Bektashiane, Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj për evidentimin, pasurimin e ruajtjen e vlerave bektashiane, duke u ndalur dhe në detaje te historiku i teqesë së lashtë të Gjakovës.

Gazetarja nga Shtetet e Bashkuara, u interesua për historinë bektashiane në Gjakovë dhe përg-

jithësisht në Kosovë. Pati interesim të veçantë për të ditur fatin e Bibliotekës së dikurshme të Teqesë së Gjakovës, që dukshëm ka fituar famë botërore, por që ka pasur fatin e keq që të digjet e shkatërron në luftën e vitit 1999. Gazetarja e National Geographic, u njoftua me rregullat fetare bektashiane, kuptoi për historinë e Teqesë së Gjakovës në luftën e Kosovës, djegien e ringritjen e saj, foto grafoi e mori shënime përdërisa dervish Rraufi i shpjegonte.

Gazetarja Stochlic pyeti për mënyrën e ruajtjes së përkthimit të Baba Qazim Bakallit, të veprës "Divani i Shamsi Tabrizit" të Rumiut; ajo bashkëndjeu fatkeqësinë e shkatërrimit të dorësh-

VIJON NË FAQEN 34 >>





krimeve të vyera e kaq të çmuara që u dogjën nga ushtria serbe më 1999, kur u dogj Teqeja, Biblioteka dhe Tyrbeja e baballarëve bektashianë në Gjakovë. Dervishi i Teqesë së Gjakovës, konfirmoi për medien amerikane përkujdesjen e vazhdueshme të Selisë së Shenjtë Bektashiane, përkatësisht të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Shenjtërisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për elokimin e vlerave të historisë tetëshekullore të bektashizmit, në hapësirat mbarëshqiptare e kudo në botë ku punojnë e jetojnë komunitete bektashianë, për bashkëjetesë fetare, paqe, mirësi e dashuri vël-lazërore. Në këtë aspekt, pasurimi i kësaj biblioteke, ka qenë dhe mbetet përparësi. Gjithashtu, ai i dhuroi gazetares amerikane librin e Baba Qazimit, me përkthimin e “Divanit...” të Rumiut. Ndërkohë, studiuesi i historisë me specializim të veçantë për orientalizmin, Prof. Dr. Nehat Krasniqi, kujtoi vitin 1991 kur kishte vizituar Teqenë e Gjakovës. Ai u shpreh se atë botë ishte mrekulluar me pasurinë e Bibliotekës së Teqesë së Gjakovës. Kujtoi se sa shumë libra e vepra të ndryshme e kishin shtëpi këtë bibliotekë. Përmendi se kishte shfletuar dorëshkrime të shumta të baballarëve bektashianë, shkrime në gjuhën shqipe, në atë turke, e në gjuhën perse, vepra që kurrë nuk i kishte parë në vende të tjera. Studiuesi Krasniqi e quajti humbje të jashtëzakonshme dhe pasuri të humbur e të pakthyeshme, shkatërrimin e bibliotekës së Teqesë Bektashiane të Gjakovës. Gjatë qëndrimit në Kosovë, gazetarja e kësaj medieje të famshme ka vizituar objekte të ndryshme laike dhe fetare, dhe është interesuar për historinë e vendit përgjithësisht, veçanërisht për ruajtjen,

*Ndër dekada, teqetë bektashiane kanë qenë vatra mikpritjeje për studiues të ndryshëm, por edhe gazetarë të shumtë. Interesim të madh, sikur në të kaluarën, ashtu dhe sot, zgjon parimi bektashian për të grumbulluar dije, për ta arkivuar atë në biblioteka e arkiv, për ta ruajtur për gjeneratat e ardhshme dhe për ta shpërndarë sa herë të ketë nevojë.*

arkivimin dhe mbrojtjen e literaturës, bibliotekave e trashëgimisë fetare para dhe gjatë luftës në Kosovë. Gjetjet e saj, në një të ardhme të afërt do të publikohen në gazetën amerikane National Geographic.

Kujtojmë se Teqeja Bektashiane e Gjakovës, përfshirë Bibliotekën dhe Tyrben, u dogj e shkatërrua nga Ushtria e serbe më 7 maj 1999. Pas luftës, Komuniteti Bektashian rindërtoi së pari Tyrben, dhe dy dhoma sa për të kryer shërbesat dhe pritjet. Më tej, më 2007, u rindërtua objekti i Teqesë së Gjakovës. Më 14 korrik 2022 shënohet përvjetori i 15-të i rindërtimit të kësaj Teqeje, që është selia e Komunitetit Bektashian të Republikës së Kosovës.





## Familja Agolli, dhuron librat e Dritëroit në bibliotekën e Selisë së Shenjtë Bektashiane

“Këndi i Naim Frashërit” dhe sensibilizimi i shkrimtarëve për pasurimin e bibliotekës së Selisë së Shenjtë Bektashiane, ishte një tjetër risi me vlerë në kuadër të “Viti i Naim Frashërit”, e në vijimësi, projekt i Kryegjyshit Botërore.

Në këtë aspekt, krejt i veçantë ishte veprimi i familjes Agolli. Pa zhurmë e pa bujë, pa lajmëruar por thjesht, mëngjesin e 22 marsit 2021, në bibliotekën e Selisë së Shenjtë vjen Artani, djali i Dritëroit.

- “Kam ardhur që t’i dhuroj bibliotekës bektashiane librat e babait. Mësuam për këtë nismë dhe thamë se është detyrë qytetare e jona, por dhe obligim për Dritëroin që si bektashi, ka shkruar jo pak dhe për bektashizmin dhe rolin e tij fetar e atdhetar” - pohoi Artani. Djali i poetit kombëtar Dritëro Agolli, u prit dhe nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, e cili e falënderoi familjen Agolli për këtë dhuratë të çmuar.

Janë mbi njëzet tituj librash që u dhuruan nga familja Agolli, ndër të cilët: Agolli, Dritëro “Arka e Djallit”, roman, Tiranë, Dritëro, 1997; Agolli,

Dritëro, “Trëndafili në gotë”, roman, Tiranë, Dritëro, 1999; Agolli, Dritëro, “Trëndafili në gotë”, roman, Tiranë, Dritëro, 2017; Agolli, Dritëro, “Lypësi i kohës”, poezi, Tiranë, Dritëro, 2018; Agolli, Dritëro, “Kalorësi lakuriq”, roman, Tiranë, Dritëro, 2016; Agolli, Dritëro, “Vjen njeriu i çuditshëm”, poezi, Tiranë, Dritëro, 2006; Agolli, Dritëro, “Vjen njeriu i çuditshëm”, poezi, Tiranë, Dritëro, 2017; Agolli, Dritëro, “Shpirti i gjyshërve”-101 këngë, Tiranë, Dritëro, 1996; Agolli, Dritëro, “Dashuri në moshën e Krishtit”-letërkëmbim, Tiranë, Dritëro, 2018; Agolli, Dritëro, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, roman, Tiranë, Dritëro, 2020; Agolli, Dritëro, “Prit edhe pak”, poezi, Tiranë, Dritëro, 2016; Agolli, Dritëro, “Shtigje dhe trotuare”, poezi, Tiranë, Dritëro, 2017; Agolli, Dritëro, “Këngët e buzëqeshjes”, Tiranë, Dritëro, 2020; Agolli, Dritëro, “Pleshti”, poemë, Tiranë, Dritëro, 2001; Agolli, Dritëro, “Tre qeshin një inatoset”, letërkëmbim, Tiranë, Dritëro, 2019; Agolli, Dritëro, “Nulla dies sine linea”, aforizma, Tiranë, Dritëro, 2017; “Ky është Dritëroi im”, kujtime, Tiranë, Dritëro, 2020; Gjinaj, Maks, “Dritëro Agolli”, bibliografi, Tiranë, Dritëro, 2003.



**RUBRIKA:** BOTIME PËR BEKTASHIZMIN DHE PERSONALITETE TË TIJ

# NAIMI SI VETË NAIMI... BEFASIA DHE VLERAT NË NJË LIBËR INTERESANT\*



*Për librin, “Naim Frashëri, apostull dhe bilbil i shqiptarizmës”, të autorëve Kujtim Boriçi e Nuri Çuni),*

**Akademik Xhevahir SPAHIU**

**M**ë duket çudi një libër i tillë në “Vitin e Naimit”, nuk ma priste mendja, por ja që u bë. Një libër (“Naim Frashëri, apostull dhe bilbil i shqiptarizmës”), me përmasa të mëdha, jo nga faqet, por gjithë tematika e brendia e mrekullueshme e tij. Falënderoj autorët Kujtim Boriçi dhe Nuri Çuni, të cilët me nismën e tyre grumbulluan dhe

sistemuan një material të pasur njëvjeçar, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në trojet shqiptare. Se aty është vetë Naimi ynë i paharruar. Naimi që mbrojti shqipëren, e lëvroi këtë gjuhë, siç ai e shpreh bukur, qartë dhe saktë, ‘Gjuhë Perëndie’. Gjuha shqipe është burim i pashtershëm i gurrës popullore, të gjuhës së thjeshtë të popullit tonë. Naimi shprehet:

*“...Pa shihni ç`gjuhë e mirë!*

*Sa shije ka hije!*

*Ç`e bukur, edh` e lirë./*

*Si gjuhë Perëndije!”*

Naimi mësoi gjuhën shqipe në teqenë e Frashërit me vëllezërit e tij, Abdyl dhe Sami, nën kujdesin e baba Alushit, vizionar, që jo vetëm i edukoi me frymën bektashiane e atdhetare tre vëllezërit, por i çoi






Nga ceremonia e promovimit të librit, në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.

në ‘Zosimea’ të Janinës, ku morën kulturën e Lindjes dhe të Perëndimit, u shkolluan dhe u bën njerëz të mëdhenj të kombit tonë. Pra, tre vëllezërit Frashëri, kishin lindur me pishtar në dorë. Ata i dhanë frymë Shqipërisë. Abdyli, Naimi, Samiu, farkëtuan ‘Zgjimim e Madh’. Nuk ishte zgjim i një njeriu a një katundi të shkretë, po zgjim i përflakur dhe dramatik i një kombi të tërë. Naimi ishte promotor i këtij zgjimi; me veprat e tij të njëpasnjëshëm i dha frymë kombëtare. Prurja e madhe në veprat “Bagëti e bujqësi”, “Historia e Skënderbeut”, “Lulet e Verës”, “Qerbelaja”, “Fletore e Bektashinjve” e, në çdo rresht e fjalë të tij...

Gjuha jonë është një nga më të moçmet në Evropë. Pra, kjo pasuri që e kanë trashëguar



shqiptarët me bekim prej Naimit, është pasuri për njerëzimin. Naimi, duke shpëtuar shqipen ka shpëtuar një pasuri të rrallë që është e rëndësishme për kulturën botërore. “Gjuhë gjeniale”, sipas Robert d’Angeli. Naimi thoshte se shqipja është “Gjuhë Perëndie”. Libri që kemi në duar, jep një mesazh të madh për të gjithë ne, për të ruajtur traditën dhe vazhdimësinë e gjuhës shqipe, Naimi si vetë Naimi.

Merreni, lexojeni dhe ruajeni këtë libër si pasuri për brezat...

**Shënim:** Në vijimësi, në numrat e revistës “Urtësia”, do të bëhet prezantimi i librave të rinj me tematikë bektashizmin dhe personalitetet e tij.

**Redaksia**





# ‘NË BALLËM SULLTAN NË MARTANESH’, NË VENDIN E SHENJTË DHE QYTETIN E PAQES

Nga Brunilda GOROVELLI

**N**ë pelegrinazhin tradicional të sivjetshëm (29 qershor 2022), në teqenë e Ballenjës, dhe sivjet, ishin të pranishëm qindra besimtarë, të cilët pa përtesë u ngjiten drejt vendit të shenjtë. Kishin ardhur nga Tirana, Martaneshi, Bulqiza, Gryka e Madhe, Durrësi, Elbasani, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Ashtu natyrshëm me gëzim pelegrinët përshëndesin njeri-tjetrin: “Të bekoftë Ballëm Sulltani”, përgjigjet tjetri “Bekim paç”. Historia e këtij Vendi të Mirë, nis shumë shekuj më parë, ku thuhet se kanë ardhur herët misionarë kalenderë, të cilët kanë lënë gjurmë.

...Thuhet bile, se ka kaluar edhe vet Ballëm Sulltani. Kjo figurë historike dhe legjendare është e njohur për bektashizmin në shek. XVI. Ballëm Sulltani, drejtoi Kryegjyshatën Botërore në Turqi (1509-1517). Ai rivendosi një sistem hierarkik të qëndrueshëm dhe rivendosi me vendosmëri rregullat kanonike dhe doktrina të besimit bektashian. Ai ka meritë të madhe në institucionalizimin dhe formësimin e tarikatit bektashian, duke bërë ndryshime në mënyrën e aplikimit të ritualeve. Vendosi rregull e disiplinë për mbarëvajtjen e veprimtarive fetare dhe të jetës së brendshme të teqeve. Bektashizmi i detyrohet shumë shërbimeve të Ballëm Sulltanit, pse ai e bëri t’i dëgjohej zëri i saj në të katër anët e botës, se kishte një bazë dhe organizim të shkëlqyer, ishte personaliteti më i madh pas Haxhi Bektashit dhe vjershëtor mistik. Prandaj në traditën bektashiane konsiderohet si Piri i Dytë. Ai shkroi poezi mistike dhe u bë i njohur në gjithë botën: “...Ai që dua unë është i Madhi Ali./ Pse? Kush do Atë nuk bëhet veli?/ Unë nga dor’ e Pirit piva kët’ doli,/ Po ti, në do Zotin, mos më nga në plagë./ Dhe plagët që kisha, të gjitha jan’ lidhur,/ Tek dashuri e Zotit veten e kam shtrydhur/ Jam Ballëm Sulltani nga Myrseli lindur,/

*Po në kujton Pirin, mos më nga në plagë...”*

Edhe në Shqipëri njihet Vendi i Mirë, i shenjtë i Ballëm Sulltanit në Martanesh me një histori interesante të kalenderit në Sopot, në legjenda dhe gojëdhëna. Gjithashtu, lidhur dhe me ngjarjet historike të luftërave gjatë shekullit XVIII-XIX vijnë dëshmi të besimit dhe dashurinë ndaj Vendi të Mirë. Kënga e popullit thotë: “...O se atje ndodhet more një Vend i Mirë./ S’durojnë pashë mor s’durojnë vezirë./ O Martanesh mos të humbë nami,/ Të ndihmoftë Ballëm Sulltani!...”

Sipas gojëdhënave, rrugët në shpellën e Ballenjës vazhdojnë gjatë, njëra kalon në rrugë shpellore për në Abaz Ali (Tomorr), kurse tjetra në Sari Salltik (Krujë). Vizitorë të huaj e kanë parë këtë shpellë si J. Sëire në vitin 1937. Sipas Hasluck, ajo ishte e ndërtuar në kohën e Karamahmud Pashë Shkodrës, pra në fund të shekullit të XVIII. Këto dy qendra (teqeja e Martaneshit dhe Ballenjës) kanë pasur gjithnjë një baba të përbashkët, megjithëse, tyrbja e vendosur në shpellë është nderuar që prej shumë





kohësh më parë se sa të ndërtoheshin teqetë.

Pelegrinët e shumtë jo vetëm që i gëzohen kësaj natyre të mrekullueshme, në lëndinat e pafund dhe pyllin e ahut dhe kroin me ujë të ftohtë pranë teqesë, ajrin e pastër dhe me ndjenjën e besimit ngjitin shkallaret tek Vendi i Mirë. Sa afroresh tek shpella ndjen atë dëshirë me besim, të falesh, të lutesh, mediton tek shpella e freskët, aty te mezaret dhe në përlësi lutesh, ndez qiri, i qetë. Pastaj del nga shpella, prap një mrekulli në natyrë, te kodra në horizont, ndërtime të njëpasnjëshme të ngritura në vite nga baba Hysni Shehu, e ka kthyer këtë vend, në një qendër të vizitueshme gjatë muajve të vitit. I pranishëm në ceremoni, ishte edhe Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili u prit nga baba Hysni Shehu. Më pas, takuan pelegrinët të të gjitha moshave... Kryegjyshi, u bëri thirrje të rinjve, që të mos largohen

nga Shqipëria, por të qëndrojnë e punojnë këtu, 'sepse vendi ynë është i bekuar dhe nuk duhet ta braktisim; Shqipërinë, e bëjnë dhe do ta bëjnë vetëm shqiptarët.'

**Më pas, sekretari i teqesë Skënder Gjoni**, hap ceremoninë, duke ia dhënë fjalën për të përshëndetur, Kryegjyshi Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ndër të tjera, Kryegjyshi tha: *"...Falënderoj të gjithë ju që keni ardhur në këtë pelegrinazh, falënderoj për pjesëmarrjen, vëllain tim, Kryegjyshin Botëror, Dede Edmond Brahimaj. Duke ardhur në këto vise gati shtatë shekuj më parë, ky shenjtor i madh do të sillte me vete, jo vetëm frymën dhe idetë e Haxhi Bektash Velikut, por edhe urtësinë dhe paqen që përcillte ky besim i mrekullueshëm midis njerëzve, që besonin Allahun e Madhëruar. Ai mundi t'i transmetojë vetitë dhe virtytet më të larta të bektashizmit në këto male të lartë, por të bukur dhe me burime ujërash të kulluar. ... Falënderoj të gjithë baballarët dhe dervishët kudo që punojnë për ta mbajtur këtë dritë të Haxhi Bektashit dhe të Ballëm Sulltanit. Zoti dhe Shenjtorët na mësojnë që ne të punojmë e të jetojmë me djersë siç i takon një njeriu. Unë gëzohem shumë që ka të rinj këtu, të cilët kanë ardhur për të marrë uratë dhe bekim, për të mësuar më mirë, për të qenë pasardhësit tanë më të zgjuar dhe më të nderuar. Me këtë rast po bëjmë një lutje bashkërisht që Zoti të na i pranojë lutjet, Kurbanët dhe gjithçka që ne i kërkojmë, Atij dhe Ballëm Sulltanit. Ballëm Sulltani është lidhësi jonë me Perëndinë, prandaj vijmë dhe lutemi këtu".*

Më pas foli baba i teqesë, Hysni Shehu, i cili u shpreh: *"...Pelegrinazhi në Ballenjë është kthyer në traditë dhe ka*

*përmesa të njëjta me pelegrinazhin që zhvillohet në: Sarisalltik-Krujë, Abaz Ali, në malin e Tomorrit, në Ballkan dhe në botë. Në këtë ditë të veçantë e shpresëdhënëse, jemi mbledhur për të adhuruar Zotin e Gjithësisë, Fuqiptotë, me këndim Kur'ani dhe me lutje e përlutje të nderojmë Ballëm Sulltanin, Pirin e Dytë të Bektashizmit, nderojmë dhe kujtojmë baballarët e ndritur, që shërbyen në teqenë tonë nga baba*

*Hyseni, baba Jashari, baba Hajdari, baba Xhaferi, baba Faja, baba Selim Kaliçani, baba Asimi e të tjerët me radhë. Mbi punën veprat shërbimet e mira që kryen për teqenë tonë. Kjo ditë qoftë e bekuar për të gjithë, sjellë paqe e harmoni për të gjithë, ashtu si drita e bekuar e Ballëm Sulltanit".*

*...Ashtu me zemër të hapur nga të gjitha bisedat që patëm me pelegrinët në adhurim të Ballëm Sulltanit, ata u shprehën: "këtu jo vetëm që ndjemë qetësi*



shpirtërore, marim uratë, takohemi me miq shokë të shumtë, të njohur dhe të panjohur. Seicili të jep ndjenjën e dashurisë, afrimin dhe vëllazërim, shtohen më shumë në këtë pelegrinazh". Ajo që krijon mjedisi shoqëror i ndryshëm, i ardhur nga larg dhe afër edhe emigrant nga Italia dhe Greqia, të rinj nga Ballkani e shtojnë më shumë miqësinë. Por mbi të gjitha adhurimi te shpella e famshme, që asnjëherë nuk u mbyll, edhe kur ishte e ndaluar me ligj (1967-1990), në ilegalitet besimtarët, dashamirësit vinin fshehurazi dhe faleshin, tek shpella e Ballëm Sulltanit, Vendi i Mirë, do të mbetet në jetë të jetëve, Vendi i Mirë. Si vetë qetësia e natyrës dhe qetësia shpirtërore është e pranishme dhe bëhet pjesë e qenies sonë. Por këtu gradualisht, vit pas viti është kthyer nga vizitorët e shumtë, jo vetëm në ditën e pelegrinazhit, por edhe gjatë vitit, në një farë mënyre do ta quanim edhe "Qyteti i paqes". Gjithmonë paçin të gjithë dashurinë e këtij vendi të shenjtë, dashurinë e Zotit të Madh! Vëllazëria dhe harmonia qofshin të përhershëm tek seicili dhe përçues kudo që punojmë se Ballëm Sulltani, të fal veç dashuri, besim dhe jetë plotë vëllazëri. Kënaqësi ishte nga të rinjtë dhe të rejtat me grupin folklorik të krahinës së Martaneshit, të veshur me kostume e bukura, si vet natyra e saj, sollën nga shpirti i tyre, gurrën e popullit me këngët bektashiane, për Ballëm Sulltanin, të traditës dhe kumboi zëri në gjithë lëndinën e Ballenjës.

Teqeja e Ballenjës është shpallur monument kulture të kategorisë I-rë nga Ministria e Kulturës me Urdhër nr. 388 datë 16.06.2017, "Vendi i Mirë Ballëm Sulltan (Guva), pranë teqesë së Vjetër".



# World Grandfather of the Bektashi Community Dede Edmond Brahimaj, 11 Years in the Lead of the Bektashi Holy See

**W**orld Grandfather of the Bektashis, Dede Edmond Brahimaj, 11 years as Leader of the Bektashi Holy See as Dede Reshati's student, Leader of World Headquarter of Bektash Community Grandfather Edmond Brahimaj, not only fulfilled the realization of these projects, the construction of the odeon in the Holy See, mosques and tombs throughout the country and beyond, but also marked a number of other achievements in the spread of the Bektashi faith, increasing the ranks of believers, giving messages of unity, religious coexistence, peace and kindness. Today, on this day, the Grandfather of the World, His Grace Haxhi Dede Edmond Brahimaj, welcomes congratulations in the Holy See, from many believers, personalities, etc.

On June 11, 2022, it was 11 years since the day when the cleric Dede Edmond Brahimaj was elected to the highest hierarchy of the Bektashi tariqat, that of the Chairman and Leader of the World Bektashi Community. This important day marks the starting point of His maximum dedication to

furthering the projects started by Dede Reshati. As Dede Reshat's student, World Grandfather of Bektashi Community His Holiness Edmond Brahimaj, not only fulfilled the realization of these projects, the construction of the "Odeon" in the Holy See, shrine and tombs (tyrbe) throughout the country and beyond, but also marked a number of other achievements in the spread of the Bektashi faith, increasing the ranks of believers, giving messages of unity, religious coexistence, peace and kindness. Today, on this day, the World Grandfather of Bektashi Community, His Grace Haxhi Dede Edmond Brahimaj, received congratulations in the Holy See, from many believers, personalities etc...

## Election of the World Grandfather of Bektashism

Dede Edmond Brahimaj was elected in the World Headquarter of the Bektashi Community after the death of

Dede Reshat Bardhi, one of the well-known personalities of Bektashism in over 800 years of its existence, who, among other things, has the special merit of reviving the Bektashi belief and objects of this faith, after the political changes of 1990 in Albania. The decision that chose Dede Edmond Brahimaj as the Leader of the World Bektashi Community was made on June ,11.2011. Among other things, this decision states: "In implementation of Article 21 of the Statute of the Bektashi World Headquarter dated on July ,26.2009 as amended and approved by Court Decision No. 4760/1 dated December ,22.2009, the Supreme Council of Grandfathers, in cooperation with The Clerical Council, gathered

today on June 11.2011 in the premises of the World Headquarter of Bektashi Community, Decided" 1-Election of Haxhi Baba Edmond Brahimaj, as the Leader of the World Bektashi Community..."

World Grandfather of the Bektashis

Haxhi Dede Edmond Brahimaj was born in Tirana on May 19, 1959. He is originally from the village of Brataj in Vlora.



He completed military and legal higher education. On January 2, 1992, he began life as a cleric, with the blessing of his spiritual leader, Haxhi Dede Reshat Bardhi and Baba Bajram Mahmutaj, thus finally being framed in the path of Haxhi Bektash Veliu. On May 16, 1996, he was consecrated with the Dervish Order and was immediately assigned to the Bektashi Grandfather of Turan, in Korça. On April 13, 1997, he was decreed with the title 'Father' "Baba". In 1997, he was appointed the Deputy of the World Grandfather of the Bektashis. On 21.02.2006, he was also appointed as the leader of Bektashism in Macedonia, based in Tetovo, simultaneously holding the position of World Vice-Grandfather of the Bektashis. On 11.06.2011, by the decision of the High Grandfather Council of the Bektashi World Grandfather, Haxhi Dede Edmond Brahimaj was elected to the high position of the World Grandfather of the Bektashians. Hax-



hi Dede Edmond Brahimaj is one of the clerics of the high Bektashi hierarchy who has made a special contribution to rebuilding the structures and infrastructure of Bektashism, in Albania and in the world.

### Commitment to Bektashism

From 1992 onwards, Haxhi Dede Edmond Brahimaj has participated in various trainings of prestigious international organizations, doctrinal courses, symposiums and various activities of a religious, humanitarian and social character, where he has referred, bringing his voice to them and the experiences of Bektashi communities around the world. In 1996, he referred to Tehran regarding Bektashi tolerance in the Balkans. On June 14, 2003, at the International Conference "Religions and Civilizations in the New Millennium", his Holiness referred to the challenges of Bektashism in the future. In June 2004, as one of the representatives of traditional Albanian religious communities, his Holiness visited the White House in the USA. His Holiness went to the USA through the US Department of State and the US Embassy in Albania, for the recognition of religious diversity in the USA. It has maintained special relations with the Bektashi Quarter in Detroit, USA, in Teqe e Baba Rexhepi, an important center of Bektashism, which became the main center of Bektashism during the time of the prohibition of religion in Albania, and has participated in various activities in this Bektashi Quarter. He holds the title "Ambassador of Peace". He participated several times in the celebrations of August 16 in Haxhi Bektash, Turkey, where he was received by the High personalities of the State of Turkey and of the "Haxhi Bektash Veliu" Institute, near Gazi University in Turkey. He was present and contributed with his lectures in various activities in Tirana, Skopje, Pristina, Ohrid, Istanbul, Ankara, Afyon, Stuttgart, Cologne, etc... Haxhi Dede Edmond Brahimaj has received many awards and high consideration from the governments of Albania, Macedonia, civil society, etc. The accredited diplomatic body in Skopje has highly appreciated Haxhi Dede Edmond Brahimaj, as a cleric with a significant contribution, especially in the fields of interreligious coexistence and religious harmony and as a promoter of the values of Albania as a model country in the world in these fields .



### Evaluations

For the contribution made to Bektashism in the world, peace and harmony in Albania and beyond, His Grace, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, has been given many official recognitions and social organizations. Among them we can mention: "Ambassador of Peace" in 2004, "Honor of Korça District" in 2004, "Honorary Citizen" of Zerqan-Bulqizë Municipality in June 2014, "Honorary Citizen" of Martanesh-Bulqizë Municipality in June 2014, "Honorary Citizen" of Bogovë-Skrapar Municipality in August 2014, "Honorary Citizen" of Frashër-Përmet Municipality, in May 2014, "Outstanding Personality of Labëria" in February 2015, "Honorary Citizen" of Fier District in March 2015, "Honorary Citizen of Berat District" in May 2015, "Honorary Citizen of Bulqiza", the title of "Knight of the Order of Skenderbeu" in September 2015, as well as in 2019 he was honored by the City Council of Memaliaj with the title of "Citizen The Honor of Memaliaj".

On June 26, 2019 Dr. Munir Kazmir, vice President of Jews Congress, honored and donated in sign of gratitude His Holiness and Bektashi Community American Flag.

On January 2021 His Holiness led the Presidency of Inter Religious Council of Albania. In the year that the Grandfather headed the Interreligious Council, the President of the Republic of Albania awarded IRCA the highest award "Honour of the Nation".

On November 18, 2021 H. Dede Edmond Brahimaj was honored with the Award " Ring of Tolerance" in Germany. The European Academy of Sciences at the Technical University of Cologne in Germany has awarded H. Dede Edmond Brahimaj, World Bektashi Grandfather and also Chairman of the Inte Religious Council for 2021, awarded his Holiness with the " Ring of Tolerance" with the motivation "For the valuable efforts in the commitments for peace and the promotion of interfaith dialogue, as a special and worthy example to be followed in building, promoting and protecting tolerance".

**Translated:  
Sheldiana Jano**



# URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE  
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË  
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE  
NR. 145 / QERSHOR / 2022



Gjashtë vjet nga takimi  
në Vatikan, i Kryegjyshit  
Botëror Bektashian,  
Dede Edmond Brahimajt,  
me Papën e Romës